


UNDP Albania Projekti Star  
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

## Plani Operacional i Zhvillimit Vendor

Bashkia Pustec



Përgatitur nga:



Instituti i Kërkimeve Urbane

*mars 2016*

## Tabela e Përmbajtjes

|   |    |
|---|----|
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....  | 1  |
| 1. Nevoja për një plan operacional të zhvillimit vendor.....                                  | 4  |
| 2. Plani operacional afatshkurtër kundrejt qeverisjes vendore dhe planifikimit afatgjatë..... | 5  |
| 3. Metodologjia e hartimit të planit operacional të zhvillimit vendor .....                   | 5  |
| 4. Diagnoza.....  | 6  |
| 4.1 Fakte kryesore .....  | 6  |
| 4.2 Zhvillimi ekonomik.....   | 8  |
| 4.3 Mirëqenia ekonomike dhe sociale.....  | 11 |
| 4.4 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore .....                                       | 12 |
| 4.5 Shërbimet publike dhe infrastruktura.....   | 14 |
| 4.6 Përfundime .....  | 16 |
| 5. Problematika operacionale afatshkurtra dhe prioritete .....                                | 17 |
| 6. Plani Operacional i Zhvillimi Lokal .....  | 21 |
| 7. POZHV në kuadër të planifikimit strategjik dhe planifikimit të territorit.....             | 38 |
| 8. Anekse .....   | 39 |
| Të dhëna dhe burimet e tyre .....   | 39 |
| Projekfishat.....   | 42 |

## Lista e tabelave

|  |    |
|--|----|
| Tabela 1: të dhëna demografike (Regjistri Civil).....  | 39 |
| Tabela 2: sipërfaqja e bashksië sipas fshatrave (bashkia Puster 2015) .....                            | 39 |
| Tabela 3: të dhëna për rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm (Bashkia Pustec 2015) .....              | 39 |
| Tabela 4: të dhëna për infrastrukturën arsimore (bashkia Pustec 2015) .....                            | 40 |
| Tabela 5: Struktura e sipërfaqes së tokës (bashkia Pustec 2015).....                                   | 40 |
| Tabela 6: struktura e sipërfaqes së tokës bujqësore (Bashkia Pustec, 2015) .....                       | 40 |
| Tabela 7: Prodhimtaria bujqësore (Bashkia Pustec, 2015) .....  | 41 |
| Tabela 8: të dhëna për blegtorinë sipas fshatrave (Bashkia Pustec, 2015) .....                         | 41 |
| Tabela 9: Popullsia banuese >15 vjec sipas gjinisë dhe gjendjes së aftësisë (INSTAT, Census 2011)..... | 41 |

## Lista e figurave

|   |    |
|---|----|
| Figure 1: Diagrama e Pemës së Problemeve.....   | 19 |
| Figure 2: Diagrama e Pemës së Objektivave ..... | 20 |

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

61 bashkitë e krijuara në vend pas zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale kanë filluar punën që prej muajit shtator 2015. Disa prej tyre janë krijuar për herë të parë nga kjo reformë, dhe disa të tjera kanë sot nën administrim një territor dhe popullsi disa herë më të madhe se më parë. Reforma riorganizoi rajonet e vendit me qëllim krijimin e njësive vendore funksionale, të afta për tu zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme mbi bazën e avantazheve të veta dhe mbi bazën e të ardhurave të veta.

Për 2-3 vitet në vazhdim është parësore integrimi i bashkive të krijuara dhe sigurimi i kohezionit mes njësive administrative përbërëse të tyre, që deri një vit më parë janë vetëqeverisur të pavarura nga njëra-tjetra; zonat rurale të bashkive janë nën vëmendje të veçantë. Njëkohësisht, është parësore përgatitja e bashkive për planifikim afatgjatë të zhvillimit socio-ekonomik të zonës së tyre. Në secilin prej drejtimeve të mësipërme, vitet në vazhdim pritet të jenë të vështirë për qeveritë e reja vendore për shkak të kapaciteteve ende të kufizuara njerëzore, infrastrukturore dhe financiare të tyre.

Mbi këtë bazë, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në bashkëpunim me UNDP Albania – Programi STAR, mori nismën të mbështesë disa bashki të përzgjedhura të vendit në hartimin e planeve operacionale të zhvillimit për vitet 2016-2018. Këto plane duhet t’iu përgjigjen nevojave parësore të bashkive për integrim, kohezion, ngritje e zhvillim kapacitetesh, por gjithashtu problemeve të mundshme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme si dhe të japin drejtim strategjik zhvillimit të sektorëve të ekonomisë. Në këtë mënyrë Plani Operacional i çdo bashkie do të shërbej si një hap i ndërmjetëm drejt ndërmarrjes së investimeve afatgjata në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të tyre dhe Planit Strategjik.

Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka mbështetur Bashkitë Devoll, Maliq, Pustec dhe Kolonjë për hartimin e këtyre planeve.

Dokumenti i këtushëm përmban planin operacional të zhvillimit të bashkisë Pustec, e cila pwrbwn njwsi administrative tw vetme.

Në këtë fazë fillestare, Bashkia e re nuk ka një dokument të PPV dhe as një plan strategjik të zhvillimit. Për rrjedhojë, puna për hartimin e planit operacional ka përfshirë përkufizimin e një vizioni të përgjithshëm të zhvillimit të zonës, vizionit për shërbimet publike, dhe vizionit të zhvillimit ekonomik, së bashku me një tërësi objektivash afatgjatë për përmbushjen e këtyre vizioneve. Një ose disa objektiva afatgjatë u përgjigjen funksioneve të vetëqeverisjes vendore. Thuajse të gjitha këto funksione janë përfshirë në plan, duke përjashtuar ata që nuk janë domethënës për qëllimin e hartimit të planit; funksionet i referohen Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, të vitit 2015.

Gjendja e tanishme në bashkinë Pustec u analizua mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga institucione vendore, rajonale, qendrore, fermerë, organizata të shoqërisë civile dhe intelektualë të zonës. Problemet janë identifikuar duke analizuar shmangiet e gjendjes së tanishme nga vizioni dhe secili objektiv afatgjatë i funksioneve të bashkisë. Pema e problemeve është ndërtuar gjithashtu në mbështetje. Forumet e diskutimit me specialistë vendorë e rajonalë të fushave të ndryshme janë përdorur si mekanizmi kryesor i sigurimit të cilësisë së analizës, prioriteteve operacionale dhe projekt-ideve.

Territori i bashkisë përkon me pellgun ujëmbledhës të liqenit të Prespës, i cili ka statusin e Parkut Kombëtar të Prespës, zonë e mbrojtur në nivel ndërkombëtar. Kjo bashki popullohet nga minoriteti etnik maqedonas të cilët janë të integruar në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit. Popullata lokale karakterizohet nga ndërveprime sociale, kulturore dhe ekonomike intensive me Republikën e Maqedonisë.

Popullsia karakterizohet shumë homogjene përsa i përket përkatësisë etnike dhe fetare. Ajo është maqedonase dhe e besimit fetar ortodoks. Popullsia dominohet nga grupmosha 15-64 vjeç, e cila përfaqëson forcën aktive të punës të popullatës lokale. Ndërsa popullsia e moshës së re është e ulët. Ndryshimet demografike të popullsisë paraqesin një trend të qëndrueshëm, pa ulje ngritje të forta, duke mos krijuar në këtë mënyrë presione zhvillimore.

Përsa i përket shërbimeve bazë si edukimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive ato më së shumti janë të lokalizuara në Pustec që përfaqëson edhe qendrën administrative, sociale dhe kulturore të jetës komunitare. Aktualisht ekziston një ndërveprim i rritur social dhe shkëmbime tregëtare dhe kulturore ndërmjet Bashkisë dhe komunave fqinje maqedonase. Këto shkëmbime janë lehtësuar nga ndërtimi dhe funksionimi i pikës së kalimit kufitar Stenje-Goricë.

Përmirësimi i infrastrukturës lidhëse rurale do të rrisë kohezion social të komunitetit në bashki dhe nga ana tjetër do të rrisë aksesin në shërbimet bazë. Impakt pozitiv do të ketë edukimi nëpërmjet rritjes së frekuentimit të shkollës së mesme në Pustec. Aktualisht, infrastruktura e dobët rrugore lidhëse ndikon negativisht në frekuentimin e shkollës së mesme nga nxënësit e fshtarave të bashkisë, në kushtet kur transporti publik, apo i nxënësve nuk ofrohet.

Furnizimi me ujë të pijshëm përfaqëson shërbimin publik prioritar për bashkinë. Për shkak të zonës në të cilën shtrihet territori i bashkisë, burimet natyrore të ujit të pijshëm janë shumë të rrallë.

Ashtu si ujësjellësi dhe KUZ-të përbëjnë çështje prioritare për ndërhyrje duke patur parasysh zhvillimin e turizmit në të ardhmen. Në këtë kontest, KUZ-të marrin rëndësi të veçantë nëse merret në konsideratë edhe pozicioni i shtrirjes së fshatrave të bashkisë. Këto sisteme KUZ që duhet të ndërtohen për të gjitha fshatrat dhe të tilla që respektojnë standartet e përcaktuara. Pajisja e kolektorëve për grumbullimin dhe trajtimin paraprak të ujrave, para se ato të derdhen në Liqen është një domosdoshmëri për mbrojtjen e liqenit nga ndotja.

Kërkesa e rritur për një shërbim efektiv të menaxhimit të mbetjeve lidhet ngushtë me zhvillimin e turizmit dhe vlerat natyrore të parkut. Cënimi i ofrimit të këtij shërbimi, dëmton dhe ul vlerat e pasura natyrore dhe turistike që ka Pusteci dhe rezultati final do të ishte kompromentimi i zhvillimit të qëndrueshëm.

Edhe pse bashkia Pustec karakterizohet nga një forcë punëtore e konsiderueshme, papunësia realisht përbën një nga problemet kryesore për popullatën vendase. Shkalla e papunësisë për bashkinë paraqitet më e lartë se mesatarja e papunësisë për vendin tonë. Papunësia e lartë, vetpunësimi i ulët lidhen me mundësitë tejet të kufizuara të aktiviteteve ekonomike në Bashki. Toka bujqësore e kufizuar dhe e fragmentarizuar, potencialet natyrore ende të pashfrytëzuara me qëllim të rritjes ekonomike janë disa nga shkaqet e papunësisë së lartë.

Konteksti ekonomik i Bashkisë përfaqësohet nga një ekonomi mikse, me prerje në disa sektorë si bujqësia, blegtoria, turizmi, peshkimi. Megjithatë, ekonomia lokale dominohet nga bujqësia dhe

është një ekonomi tipike rurale dhe pse bujqësia paraqet aktivitet jo shumë produktiv. Turizmi përfaqëson sektorin që po merr hov dhe pritet të jetë dretimi kryesor ekonomik në të ardhmen për shkak të potencialit që ka për rritjen e ekonomisë lokale.

Krijimi i sinergjive mes projekteve të zbatuara dhe atyre që do të planifikohen është një mundësi që nuk duhet humbur, për të pasur rezultate të qëndrueshme drejt një vizioni të përbashkët për zhvillimin e zonës.

Peshkimi përfaqëson një sektor ekonomik me traditë në bashkinë e Pustecit dhe si i tillë ai duhet të konsolidohet ndërsa aksesimi në tregje të mundësohet. Ngjashëm mund të thuhet edhe për aktivitetin e mbledhjes së bimëve mjekësore eterovajore e tanifere (MET). Rivitalizimi i një aktiviteti të tillë do të kërkojë edhe aftësimin e popullatës lokale për vjeljen e tyre në mënyrat e duhura, me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë mjedisore.

Ndërhyrje për përmirësimin e sistemit të vaditjes së tokave bujqësore do të sjellë rritjen e prodhimit bujqësor, që mund të konsiderohet edhe si faktor nxitës i fermerëve për të bashkuar parcelat e tyre për krijimin e ndonjë kooperative me qëllim përfitimin nga politikat dhe subvencionet e shtetit për këtë sektor.

Mbi bazën e kësaj analize dhe përfundimeve të saj, janë përcaktuar ndërhyrjet/investimet më prioritare të çdo fushe për vitet 2016-2018, si dhe projekti-ide të mundshme për vënien në jetë të tyre.

## 1. Nevoja për një plan operacional të zhvillimit vendor

Në fazën e tanishme të rikrijimit të njërive të qeverisjes vendore në vend pas zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore ka marrë nismën për pajisjen e një grupi njëvësh të reja të qeverisjes vendore të vendit me plane operationale të zhvillimit që mbulojnë periudhën kohore 2016-2018. Qëllimi është mbështetja dhe nxitja e integritit dhe kohezionit mes njërive përbërëse të bashkive të reja në 2-3 vitet e para të funksionimit të tyre si një njësi e vetme, të cilat priten të jenë më të vështira për sa i përket kapaciteteve njerëzore, metodologjisë dhe fondit financiar të tyre. Funksionet e vetëqeverisjes vendore gjithashtu janë rishikuar dhe zgjeruar në ligjin e ri të vitit 2015, duke parashikuar kompetenca më të gjera të 61 bashkive për zhvillim afatgjatë socio-ekonomik të rajoneve të vendit.

Njëkohësisht, nisma është pjesë e Programit STAR, i financuar nga një grup donatorësh dhe i menaxhuar nga UNDP Albania, për mbështetjen e Qeverisë Shqiptare në ndërmarrjen e Reformës Administrative dhe Territoriale në vend. Programi mbulon procesin e plotë të reformës, me të gjithë aktorët, dhe qëllimin bazë të saj për përforcimin e qeverisjes vendore dhe rolit të saj në zhvillimin vendor. Kështu, ai parashikon mbështetje financiare dhe menaxheriale të njërive të qeverisë vendore për ngritjen e zhvillimin e kapacitetit për realizimin e funksioneve vendore dhe përmirësimit të efikasitetit të tyre. Mbështetja e bashkive në hartimin e planeve operationale të zhvillimit vendor është projekti i radhës brenda Programit STAR.

Plani operacional i zhvillimit vendor është një instrument planifikimi afatshkurtër të zhvillimit të njërive të qeverisjes vendore. Për nga natyra, një plan operacional hartohet në mbështetje të një plani strategjik, duke zbrëthyer hapat – veprimet, investimet – që do të përmbushin objektivat strategjike afatgjatë të përcaktuar në këtë të fundit.

Është e nevojshme që bashkitë e formuara të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme bazuar në planet vendore territoriale si dhe planet vendore strategjike të zhvillimit. Këto dy procese planifikimi janë funksione të veçanta të qeverisë vendore të përcaktuara me ligj. Ndërsa bashkitë do të hartojnë këto plane afatgjata zhvillimi, një plan veprimi afatshkurtër do të jetë i nevojshëm për të mbuluar periudhën deri në fillimin e zbatimit të tyre, si një hap i ndërmjetëm në të cilin elementët bazë të vizionit të zhvillimit të bashkive do të përkufizohen dhe një tërësi prioritetesh afatshkurtra do të adresohen.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve e Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të përbëjnë një burim financiar të rëndësishëm për bashkitë në realizimin e investimeve kapitale që adresojnë infrastrukturën vendore për shërbimet publike dhe ekonominë.

Fondi tashmë i parashikuar i një numër investimesh vendore kryesisht në infrastrukturën e shërbimeve publike, të cilat janë vlerësuar prioritete operationale edhe gjatë procesit të hartimit të planit, janë renditur në këtë plan si projekt-ide për t'u zbatuar në vitin 2016, me pjekuri rrjedhimisht të lartë.

## 2. Plani operacional afatshkurtër kundrejt qeverisjes vendore dhe planifikimit afatgjatë

Në Bashkinë Pustec Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) nuk kanë nisur ende të hartohet; për rrjedhojë hartimi dhe miratimi i tij brenda kohës së përcaktuar në ligj përbën një prioritet absolut për qeverinë vendore dhe në këtë mënyrë bëhet pjesë e planit operacional të zhvillimit të bashkisë si hapi kyç i mandatit të saj. Gjithashtu mungon një dokument të zhvillimit afatgjatë apo strategjik të zonës së re që përfshihet nën administrimin e saj.

Për rrjedhojë, plani operacional afatshkurtër i ka paraprirë përcaktimit të hollësishëm të vizionit dhe objektivave të bashkisë, dhe për këtë arsye është mbështetur në një vizion dhe objektiva më të përgjithshëm të ekonomisë së zonës dhe shërbimeve publike. Kjo ka bërë të mundur përqendrimin e planit operacional në disa fusha që janë vlerësuar prioritare për ndërhyrje/investime të cilat nuk do të bien ndesh me investime më madhore afatgjata që bashkia mund të kryejë pas miratimit të PPV apo një planifikimi strategjik të zhvillimit. Në këtë mënyrë, plani operacional i këtushëm i hap rrugë drejtimeve më kryesore të zhvillimit afatgjatë të zonës, ndërsa adreson dhe një sër problemesh afatshkurtra.

Ndërkohë, Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) për Zhvillimin e Territorit të Shqipërisë 2015-2030 është aktualisht në hartim e sipër nga qeveria qendrore, dhe ka detyrimin ligjor të miratohet nga Këshilli i Ministrave jo më vonë se muaji maj 2016, sipas Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Njëkohësisht, në bazë të këtij ligji, autoritetet vendore duhet të hartojnë dhe miratojnë planet përkatëse vendore jo më vonë se muaji shtator 2016.

PPK Paraparak i vitit 2015 jep disa drejtime bazë të zhvillimit për Bashkinë Pustec. Në lidhje me zhvillimin afatgjatë të territorit sipas këtij plani paraparak qendra e bashkisë, qendra Pustec e bashkisë, është *qendër lokale*, ndërsa do të përfshihet në *korridorin strategjik të zhvillimit* Tiranë-Athinë. Gjithashtu, Bashkia Pustec është pjesë e zonave me *potencial zhvillimi ndërkuftar* nëpërmjet segmentit Pogradec-Ohër për turizmin natyror (liqenor).

Këta komponentë janë përcjellë në vizionin dhe objektivat afatgjatë mbi bazën e të cilëve janë vlerësuar prioritetet operacionale të Bashkisë Pustec, me arsyetimin që PPV apo çdo planifikim strategjik vendor që do të ndërmerret nga Bashkia në vitet në vazhdim duhet të pasqyrojë të njëjtët komponentë.

## 3. Metodologjia e hartimit të planit operacional të zhvillimit vendor

Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka përgatitur Planin Operacional të Zhvillimit Vendor (POZHV) për Bashkinë e Pustecit sipas strukturës të kërkuar nga Ministri e Shtetit për Çështjet Vendore, të theksuara në Termat e Referencës të Projektit.

Gjendja e tanishme në bashkinë Pustec u analizua mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga institucione vendore, rajonale, qendrore, nga fermerë, organizata të shoqërisë civile dhe intelektualë të zonës. Të dhënat janë mbledhur përmes takimeve individuale dhe forumeve të diskutimit; pyetësorë janë hartuar në disa raste me qëllim përmbledhjen më të saktë tabelare të të dhënave. Koordinatorët vendorë kanë qenë mbështetje kryesore në këtë proces, duke përfituar nga vendndodhja dhe njohuritë për zonën.

Forumet e diskutimit me specialistë vendorë e rajonalë të fushave të ndryshme janë përdorur si mekanizmi kryesor i sigurimit të cilësisë së analizës, prioritetëve operacionale dhe projekt-ideve.



Gjithashtu, gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave janë përdorur treguesit gjinore, të cilët kanë orientuar edhe diskutimet në forume, analizën, përcaktimin e prioriteteve operacionale, përgatitjen e fishave të projekt-ideve, me qëllim përgatitjen e planeve operacionale për zhvillimin lokal, të ndjeshme nga perspektiva gjinore.

Metoda 4R<sup>1</sup> u përdor për të ndihmuar analizimën e mirëqenies socio-ekonomike të bashkisë nga perspektiva e barazisë gjinore. Njëkohësisht kjo metodë ofroi një pamje të përgjithshme edhe të ndryshimeve që kërkohen për të përmbushur nevojat e ndryshme të grave dhe burrave përmes ndërhyrjeve të reja apo të ndryshuara.

Puna për hartimin e planit operacional ka përfshirë përkufizimin e një vizioni të përgjithshëm të zhvillimit të zonës, vizionit për shërbimet publike, dhe vizionit të zhvillimit ekonomik, së bashku me një tërësi objektivash afatgjatë për përmbushjen e këtyre vizioneve. Një ose disa objektiva afatgjatë u përgjigjen funksioneve të vetëqeverisjes vendore. Thujse të gjitha këto funksione janë përfshirë në plan, duke përjashtuar ata që nuk janë domethënës për qëllimin e hartimit të këtij plani; funksionet i referohen Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, të vitit 2015.

Problemet janë identifikuar duke analizuar shmangiet e gjendjes së tanishme nga vizioni dhe secili objektiv afatgjatë i funksioneve të bashkisë. Pema e problemeve është ndërtuar gjithashtu në mbështetje.

Në këtë mënyrë, plani operacional përbëhet nga një tërësi hapash dhe projekt-investimesh të cilat kanë këta objektiva specifikë:

- a. shtrirjen e rrjetit rrugor në zonat ku aktualisht mungon,
- b. shtrirjen e shërbimeve publike në zonat ku aktualisht mungon,
- c. përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve publike ku është e nevojshme,
- d. zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive,
- e. ngritja e kapaciteteve vendore për ofrimin në të ardhmen të shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse, me element gjinor të përforcuar,
- f. mbrojtja e mjedisit dhe vlerave natyrore me qëllim hapjen e mundësisë së shfrytëzimit të tyre në të ardhmen për zhvillimin socio-ekonomik të zonës,
- g. hedhjen e bazave për planifikim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të zhvillimit të zonës,
- h. qasje strategjike ndaj problematikave bazë të zhvillimit të bujqësisë, përgjigje ndaj nevojave të menjëhershme për ndërhyrje si për shembull, në zona aktualisht të ndotura të mjedisit

## 4. Diagnoza

### 4.1 Fakte kryesore

Bashkia e Pustecit bën pjesë në rrethin dhe qarkun e Korçës dhe ndodhet në skajin verilindor të Qarkut. Bashkia kufizohet në perëndim me bashkitë Pogradec dhe Maliq, ndërsa në veriperëndim dhe lindje me Republikën e Maqedonisë dhe në jug e juglindje me Greqinë. Kryeqendra e bashkisë së re është fshati i Pustecit, i cili ndodhet 25 km larg nga qyteti i Korçës. Bashkia e re e Pustecit përbëhet nga një njësi administrative. Kjo për shkak se reforma territoriale aplikoi

---

<sup>1</sup> Metoda origjinle u zhvillua rreth fundit të viteve 1990 në një projekt the Shoqatës Suedeze të Autoriteteve Lokale të quajtur JämStod.

kritere të veçanta që lidhen me shumicën e popullsisë etnike që jeton në territorin e bashkisë. Përndryshe, Bashkia e re e Pustecit është ish komuna Liqenas, emër zyrtar që u përdor në periudhën kohore 1973-2013.

Bashkia ka nën administrimin e saj 9 fshatra, të cilat janë: Liqenas, Shulin, Leska, Zarashka, Cerje, Goricë e Madhe, Goricë e Vogël, Diellas, Gollomboc, të cilat shtrihen në një gjatësi prej 45 km. Territori i bashkisë shtrihet në një sipërfaqe prej 1363.8 ha. Dëndësia e popullsisë është 94 banorë/km<sup>2</sup>. Fshati më i madh për nga sipërfaqja është qendra e bashkisë, Pusteci si dhe fshati Gorica e Madhe. Këto fshatra, të dyja së bashku, përfaqësojnë 35% të territorit të bashkisë.

Territori i bashkisë përkon me pellgun ujëmbledhës të liqenit të Prespës, i cili ka statusin e Parkut Kombëtar të Prespës, zonë e mbrojtur në nivel ndërkombëtar.

Fshatrat janë të shpërndarë në të gjithë territorin e bashkisë duke pasur si qendër organizimi liqenin. Shumica e fshatrave shtrihen buzë tij dhe përreth tij. Një pjesë e vogël e fshatrave shtrihen pak më larg, ndërsa Cerje është fshati që ndodhet në terren malor. Banesat e fshatrave karakterizohen nga stil i njëjtë ndërtimi, gati uniform, shtëpi një ose dy katëshe, me veranda, dhe fasada kryesisht të bardha.

Kjo bashki popullohet nga minoriteti etnik maqedonas të cilët janë të integruar në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit. Gjithashtu, popullata lokale karakterizohet nga ndërveprime sociale, kulturore dhe ekonomike intensive me Republikën e Maqedonisë.

Popullata lokale gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë njerëzore. Në bashki sot valëvitet dielli, flamuri kombëtar maqedonas dhe i Republikës së Maqedonisë. Nëpër tabelat e rrugëve dhe të shesheve gjuha maqedonase është përkrah gjyhës shqipe. Edhe emri aktual i bashkisë - Pustec - u bë i mundur nëpërmjet miratimit të Ligjit për kthimin e emrit maqedonas të njësisë vendore të inicuar nga njësisia e qeverisjes vendore, komuna e Liqenasit. Për më tepër, sheshi në qendrën e Pustecit mban emrin e revolucionarit maqedonas Goce Delçev.

**Demografia.** Popullsia e bashkisë arrin në 3,290 banorë (Census 2011), ndër të cilët 1,725, ose 52% e popullsisë, janë meshkuj dhe 1,565 (ose 48%) janë femra. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, popullsia raportohet të jetë 5,345 banorë (1421 familje). Fshati më i madh i bashkisë është Pusteci me një popullsi prej 1250 banorë. Fshatrat e tjerë kanë popullsi më të vogël se 1000 banorë. Disa prej fshatrave kanë popullsi të ulët, që varion nga 200 deri 500 banorë. Fshati më i vogël për nga popullsia është Cerje. Popullsia e bashkisë dominohet më shumë nga grupmosha 15-64 vjeç, e cila përbën 70.4% të popullsisë totale dhe përfaqëson forcën aktive për punë të komunitetit. Ky tregues është mbi mesataren e vendit. Grupmosha 0-14 vjeç përbën 14.6 % të popullsisë që krahasuar me mesataren e vendit është tregues i ulët, ndërsa mosha e tretë (65 vjeç+) përfaqëson 15% të popullsisë së bashkisë<sup>2</sup>. Në përfundim, mund të themi se Pusteci ka një popullsi të konsiderueshme të forcës aktive punëtore, por nga ana tjetër popullsi të vogël të të rinjve.

**Dinamika e popullsisë.** Bazuar në të dhënat e Regjistrimit Civil për periudhën 15 vjeçare (2000-2015) popullsia lokale është rritur me 21% (ose 928 banorë). Rritja më e madhe ka ndodhur përgjatë viteve 2005-2010 me 561 banorë. Ndërsa në vitet 2015-2010 rritja ka qenë shumë e vogël, 29 banorë (Shih Aneks, tab.nr.1). Në lidhje me numrin e emigrantëve të kthyer gjatë

---

<sup>2</sup> INSTAT, Census 2011

periudhës 2001-2011 numërohen 120 persona<sup>3</sup>. Një tendencë e tillë demografike nuk krijon presione zhvillimore.


## 4.2 Zhvillimi ekonomik

Konteksti ekonomik i Bashkisë përfaqësohet nga një ekonomi mikse, me prerje në disa sektorë si bujqësia, blegtoria, turizmi, peshkimi. Megjithatë, ekonomia lokale dominohet nga bujqësia dhe është një ekonomi tipike rurale. Bujqësia përbën drejtimin kryesor ekonomik të popullatës (me një peshë specifike të pemëtarisë) dhe pse ajo paraqitet si aktivitet jo shumë produktiv. Turizmi përfaqëson sektorin që po merr hov dhe pritet të jetë dretimi kryesor ekonomik në të ardhmen për shkak të potencialit që ka për rritjen e ekonomisë lokale.

### 4.2.1 Bujqësia


Bashkia është një njësi vendore tipike bujqësore, edhe pse angazhimi i popullatës lokale në këtë sektor është tejet e kufizuar për shkak të një serie problemesh që manifeston ky sektori, ku ndër më kryesorët përmendim: rendimenti shumë i ulët bujqësor si pasojë e terrenit të thyer kodrinor, mungesa e vaditjes dhe aksesit i ulët në treg.

Sipërfaqja e tokës bujqësore për bashkinë Pustec është 1405.83 ha, 97% e së cilës i është ndarë popullatës lokale. Sipërfaqja e kultivuar është 1000 ha, pjesa tjetër është e pa kultivuar. Struktura e tokës së punueshme dominohet nga toka arrë, dhe në një pjesë të vogël nga vreshta dhe pemëtore, sipas paraqitjes së mëposhtme grafike. Fshati Pustec ka sipërfaqen më të madhe të tokës arrë, ndërsa Lajthiza fshati me sipërfaqen më të vogël. Sipërfaqja më e madhe e pemështeve shtrihet në Pustec dhe Gollomboc, ndërsa përsa i përket vreshtave, 40% e sipërfaqes së tyre është lokalizuar në Pustec. (Shih Aneks tab.nr.6)



Ka ndryshim në strukturën e mbjelljeve midis periudhave kohore para viteve '90 dhe pas saj. Këto ndryshime lidhen me sipërfaqen e reduktuar të tokës bujqësore që është e ujitshme, me rritjen e sipërfaqes së tokës djerrë dhe të sipërfaqes së livadheve dhe kullotave. Sipërfaqen më të madhe të mbjellë e zënë drithërat e bukës, ndër të cilat gruri, foragjeret, vreshtaria, pemëtaria, perime dhe fasule dhe çaj mali. Më poshtë jepet grafiku që tregon kulturën bujqësore dhe sipërfaqen në ha të mbjellë me këto kultura (Shih Aneks, tab.nr.7).

<sup>3</sup> Po aty



Gjatë dekadës së fundit, fermerët kanë treguar interes për të shtuar sipërfaqet e mbjella me vreshtari, kumbulla dhe mollë. Gjithashtu, fermerët kanë treguar interes edhe për kultivimin e çajit të malit, duke mbjellë rreth 3 ha me këtë kulturë. Sipërfaqja e mbjellë me çaj mali por rritet vazhdimisht.

Tabela tregon sipërfaqen (ha) për secilën kulturë bujqësore dhe % që kjo sipërfaqe zë në sipërfaqen totale të tokës bujqësore në territorin e bashkisë.<sup>4</sup>

| Kultura bujqësore | Sipërfaqe ha | % që zë ndaj totalit të sip. totale të tokës bujqësore |
|-------------------|--------------|--|
| gruri             | 318          | 23%  |
| misër fasule      | 251          | 18%  |
| perime dhe patate | 92           | 7%   |
| foragjere         | 257          | 18%  |

Prodhimi bujqësor është i ulët dhe më shumë përdoret për përdorim familjar dhe shumë pak tregëtohet, për shkak të aksesit të ulët në treg. Ndërsa rritja e prodhimit bujqësor duket tejet i pamundur po të kihet parasysh mungesa e ujitjes së tokave. Të ardhurat shumë të pakta që gjenerohen nga aktiviteti bujqësor e bëjnë këtë sektor jo tërheqës për të rinjtë, cilët gjithnjë e më shumë largohen për t'u vendosur pranë qendrave urbane. Sektori karakterizohet nga femra të vogla, familjare. Numri i tyre është 946, të cilat kanë rreth 3 dy/frymë.

Edhe pse bujqësia përfaqëson aktivitetin kryesor ekonomik, sektori vuan nga një sërë problemesh që vështirësojnë zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, të cilat janë të ngjashme në të gjithë zonat rurale të vendit: mungesa e ujitjes, niveli i ulët i mekanizimit të bujqësisë, çmimet e larta të shërbimeve mekanike, numri i madh i parcelave, sipërfaqja e ulët e tyre, kosto e rritur e prodhimit, aksesit i ulët në tregje etj.

#### 4.2.2 Blegtoria

Blegtoria paraqet një sektor ekonomik në rënie. Kjo tregohet me reduktim shumë të madh të numrit të krerëve, sidomos numri i të dhirtave. Statusi i territorit si Park i mbrojtur kufizon kullotjen e bagëtive për shkak të dëmtimeve që ato shkaktojnë. Nisur nga kjo pikëpamje mjedisore pritet që numri i tyre të jetë vazhdimisht në rënie. Ndërsa numri i lopëve ka njohur

<sup>4</sup> Të dhëna Bashkia Pustec 2015

rritje, por fermerët nuk paraqesin interes për rritjen e numrit të tyre, në kushtet kur mbledhja e produkteve blegtorale nuk është e garantuar dhe aksesit në tregje është i ulët.

Numri më i lartë i të imtave, gjedhit dhe shpendëve është e lokalizuar në fshatrat Pustec, Goricë e Madhe dhe Kallamas (Shih Aneks, Tab.nr.8).

#### 4.2.3 Peshkimi

Peshkimi përfaqëson një sektor ekonomik me traditë në bashkinë e Pustecit. Që para vitit 1990 kanë funksionuar dy brigada peshkimi me pesë motobarka. Për një periudhë kohë peshkimi bëhej i paorganizuar, ndërsa pas vitit 2002 është krijuar dhe funksionon Shoqata e Peshkimit, në të cilën bëjnë pjesë 30 peshkatarë të licensuar. Peshkatarët e kësaj shoqate aplikojnë lloje të ndryshme peshkimi.

Peshkimi mund të rezultojë një sektor fitimprurës për banorët e fshatrave afër liqenit nëse do të mundësohet sigurimi i tregut. Ky sektor që të forcohet ka nevojë edhe për projekte që lidhen me kultivimin e peshkut me qëllim shtimin e tij në liqen. Qendra të kultivimit të peshkut duhet të riaktivizohen në momentin që sigurohet aksesit në tregje.

#### 4.2.4 Turizmi

Zhvillimi i turizmit paraqet potencialin më të madh për rritjen ekonomike të popullatës lokale. Mendohet që një turizëm i zhvilluar do të nxisë dhe do të kërkojë zhvillimin e bujqësisë. Prodhimet bujqësore që prodhohen në territor janë biologjikisht të pastra. Bashkia e Pustecit ka potenciale të jashtëzakoshme për të nxitur zhvillimin e turizmit si një mundësi për rritjen ekonomike të popullatës lokale. Aktualisht, nuk mund të themi se ky sektor paraqet një drejtim të mirëfilltë ekonomik, por ka gjasa që e ardhmja të jetë premtuese përse i përket përfshirjes së popullatës lokale në këtë sektor. Potencialet për zhvillimin e turizmit lidhen më burimet e mëdha të zonës. Territori i bashkisë përkon me Parkun Kombëtar të Prespës, një nga 15 parqet kombëtare të vendit tonë, zonë e mbrojtur, e shpallur edhe zonë Ramsar. Në shtator të vitit 2008, Prespa u zgjodh nga Lonely Planet si një nga njëzet destinacionet europiane. Eksperienca rajonale dhe ajo europiane ka dëshmuar se parqet natyrore, kthehen në pika të forta të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet turizmit.



Territori ka atraksione të shumta natyrore, që favorizojnë zhvillimin e turizmit. Liqeni i Prespës, pamjet e bukura panoramike dhe ndërthyrje harmonike të pejsazhit, gatimet tradicionale, ndërtesat e vjetra buzë liqenit të Prespës nga shekujt 13 dhe 14, si dhe ishulli i Maligradit (monument natyre) dhe Kisha e Shën Mërisë (monument kulture) përbëjnë atraksionet kryesore të zonës. Pusteci është zonë e peisazheve piktoreske, e gërshetimit të vlerave tradicionale, kulturore e historike, me vlera të pasura arkeologjike dhe biospeleologjike, me biodiversitet shumë të pasur, strehë e shumë koloni zogjsh, disa prej të cilëve në zhdukje. Përreth vijës liqenore, nga Kallamasi në Liqenas, zonë e përcaktuar si përparësore për zhvillimin e turizmit, ekzistojnë plazhe ranone dhe shkëmbore të cilat mund të kthehen në pika të preferueshme për vizitorët nëse investohet për sistematizimin tyre. Parku natyror kombëtar i Prespës ka potenciale për të qenë element i fortë në rritjen ekonomike të popullatës lokale.

Prespa paraqet një listë të gjatë të vendeve kulturore dhe historike për t'u vizituar. Disa prej tyre janë: ishulli i Neolitit, në afërsi të fshatit Kallamas, kompleksi nënujor në Staro Sello, rruga romake, kisha, shpella dhe manastire të shumtë.

Në bashki ka një Qendër Edukimi dhe Informacioni për Parkun Kombëtar Prespa në Goricë të Vogël që synon informimin e publikut për vlerat natyrore dhe njëkohësisht shërben edhe për informim turistik. Të tjera institucione lokale janë të përfshirë në promovimin e zonës dhe ofrimin e informacionit turistik, të tilla si: Shkolla e mesme e përgjithshme në Pustec, shkolla 9-vjecare në Goricë e Vogël. Aktualisht Bashkia bën një punë të mirë në ndërgjegjësimin e publikut për ruajtjen, mbrojtjen e biodiversitetit të zonës, nëpërmjet mesazheve ndërgjegjësuese, informimit rreth vlerave natyrore etj.

Aktualisht, ka një numër të konsiderueshëm turistësh dhe vizitorësh që gjithnjë e më shumë po njihen. Shumica e tyre, pothuajse 75-80% janë vizitorë ditor, ndërsa pjesa tjetër akomodohen në fshtatrat e bashkisë për të ndenjur rreth 1-2 ditë. Numri i hoteleve që funksionojnë është ende i vogël, ndërsa është rritur numri i familjeve nëpër fshatra që kanë përshatur shtëpitë e tyre për pritje dhe akomodim të turistëve.

Një nga festat lokale që po kthehet në traditë është edhe Festa e Verës në Prespë, që synon promovimin e kësaj zonë të mbrojtur. Festa të tilla lokale duhet të kthehen në traditë të zonës sepse kanë potencialin për t'u kthyer në promotor të zhvillimit të turizmit.

Ndërkohë, një sërë investimesh të kryera nga qeverisja lokale kanë synuar ruajtjen e vlerave natyrore, kulturore dhe historike si dhe rivitalizimin e qendrave të banuara. Rehabilitimi i Kishës së Shën Arhangel Mihail, rikualifikimi i sheshit në Glloboçan dhe vendosja e përmendores së Sterio Spases, ripyllëzimi i manastirit "Shën Marena", rikualifikimi i sheshit Goce Delev; sigurimi i anijes me energji solare për shëtitje në ishull, ndërtimi i limanit të vogël për anijet e vogla në Pustec dhe Tuminec, Glloboçan dhe Goricë të Poshtme, mbjellja e drunjve të blirit. Të gjitha këto iniciativa janë një tregues që ka një seri përpjekjesh, të cilat kanë shtruar rrugën për të tjera në të ardhmen. Krijimi i sinergjive mes projekteve të zbatuara dhe atyre që do të planifikohen është një mundësi që nuk duhet humbur, për të pasur rezultate të qëndrueshme drejt një vizioni të përbashkët për zhvillimin e zonës.

### 4.3 Mirëqenia ekonomike dhe sociale

Nisur nga burimet e të ardhurave familjare, bashkia e Pustecit karakterizohet nga përqindje e ulët e njësive ekonomike familjare (NjEF) me ndihmë sociale dhe remitanca si burime të të ardhurave familjare. Indeksi për këto tregues është 5% për ndihmën sociale dhe 2.3% e NjEF për remitancat. Gjithashtu, numri i emigrantëve të kthyer gjatë vitit 2001-2011 është i ulët dhe arrin 120 persona.<sup>5</sup>

Nga skema e asistencës sociale trajtohen rreth 70 familje, nga 1,453 familje që ka bashkia. Ky numër familjesh përbën 4.8% të totalit të familjeve. Numri i familjeve që kanë kryefamiljare femra është 8.8% të familjeve, tregues ky që është i ulët krahasuar me mesataren e vendit.

Në lidhje me popullsinë lokale me aftësi të kufizuar >15 vjeç, treguesit raportojnë se ajo përfaqëson 8% të popullsisë totale të bashkisë >15 vjeç.

---

<sup>5</sup> INSTAT, Census 2011

Në total, 231 banorë janë me aftësi të kufizuar, 92 prej të cilëve (ose 40%) janë meshkuj, dhe 139 (ose 60%) janë femra. (Shih Anekse, tab. Nr.

**Papunësia.** Edhe pse bashkia Pustec karakterizohet nga një forcë punëtore të konsiderueshme papunësia realisht përbën një nga problemet kryesore për popullatën vendase. Shkalla e papunësisë për bashkinë paraqitet më e lartë se mesatarja e papunësisë për vendin tonë. 36.8% e forcës punëtore shtë e papunë, kur mesatarja për vendin e këtij treguesi është 29.2%. më e përkeqësuar paraqitet situata për të rinjtë (mosha 15-24 vjeç) dhe gratë, ku 82.3% e të rinjve dhe 55.6% e grave janë të papunë. Këto indekse janë shumë më të larta se mesatarja e vendit.

Ndërsa përsa i përket vetpunësimit, Pusteci përsëri paraqet një përqindje shumë të ulët të forcës punëtore, më të ultën në vend (21.7%)


Papunësia e lartë dhe vetpunësimi i ulët lidhen me mundësitë tejet të kufizuara të aktiviteteve ekonomike në Bashki. Toka e kufizuar bujqësore dhe e fragmentarizuar, potencialet natyrore ende të pashfrytëzuara me qëllim të rritjes ekonomike janë disa nga shkaqet e papunësisë së lartë. Sektori publik ka numrin më të lartë të të punësuarve, rreth 77 persona, nga të cilët 39, ose 51% janë femra. Sektori i arsimit është sektori me numrin më të lartë të punësimit. Ndërsa në sektorin privat janë të punësuar 12 persona, nga të cilët 42% janë femra, të cilat janë të angazhuara në hoteleri dhe restorante.<sup>6</sup>

## 4.4 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore

### 4.4.1 Parku Kombëtar "Prespa"

Parku (me natyrë ndërkuftare) me një sipërfaqe prej 27,750.00 ha paraqet një zonë të mbrojtur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duke qenë se ka statusin e zonës RAMSAR. Ky park përkon me territorin e Bashkisë Pustec. Parku karakterizohet nga biodiversiteti i pasur, i rëndësishëm për shpendët, strehë e shumë zogjve. Në këtë zonë takohen shumë shpendë, disa prej tyre janë edhe lloje globalisht të kërcënuar. Bimësia e Parkut karakterizohet nga pyje ahu dhe kullotat subalpine e alpine, ku takohen disa bimë të rralla. Zona ofron peisazhe mahnitëse dhe është e pasur me vlera natyrore, tradicionale, kulturore e historike. Zona të shumta me vlera arkeologjike dhe biospeleologjike ndodhen gjithashtu në këtë park.

Pyjet përfaqësojnë ekosistemin natyror më të rëndësishëm, me sipërfaqe më të madhe dhe larminë biologjike më të pasur. Në këto pyje ka disa lloje bimësh që janë endemike për rajonin tonë dhe te tjera që rrezikohen të zhduken. Sipërfaqja e përgjithshme e



<sup>6</sup> Të dhëna nga Bashkia Pustec, 2015

tyre është 11,473 ha, nga të cilët, vetëm 7,316 ha janë shtetërore, 3,723 ha janë në përdorim të komunës dhe pjesa tjetër janë pyje private.<sup>7</sup> Këto pyje, para viteve '90 kanë përfaqësuar një burim të rëndësishëm të furnizimit me dru zjarrri dhe lëndë drusore. Ndërsa pas këtyre viteve, këto sipërfaqe kanë qenë subjekt i shkatërrimeve massive. Megjithatë projekte për të përmirësuar pyjet janë zhvilluar me mbështetje të shumë donatorëve dhe prej shoqatës së përdoruesve të pyjeve komunale dhe firmave të ndryshme.

#### 4.4.2 Kullotat natyrore

Kullotat natyrore në territorin e bashkisë, kapin një sipërfaqe prej afërsisht 1,485 ha, nga të cilat, rreth 800 ha kullota shtetërore (alpine), rreth 300 ha kullota komunale dhe rreth 380 ha kullota private.<sup>8</sup>

#### 4.4.3 Pejsazhi malor dhe ekosistemet.

Relievi i bashkisë është i larmishëm dhe dinamik. Terreni malor gërshetohet me atë kodrinor dhe me fushat që kanë trajtën e luginave që përfundojnë në liqen. Gërshetimi i pejsazheve malore, kodrinore dhe liqenore ofron pamje piktoreske. Një pejsazh i tillë i larmishëm, dhe gërshetimi harmonik i formave të ndryshme duhet ruajtur i paprekur nga aktiviteti njerëzor me qëllim që një vlerë e tillë të mos humbasë.

#### 4.4.4 Bimët mjekësore

Bimët mjekësore përfaqësojnë një tjetër pasuri natyrore të zonës. Ka një shumëllojshmëri të tyre në këtë zonë. Nga studime të ndryshme janë evidentuar rreth 330 dhe 220 lloj bimësh mjekësore dhe eterovajore.<sup>9</sup> Grumbullimi i këtyre bimëve ka qenë aktivitet ekonomik i popullatës lokale. Aktualisht, me përjashtim të çajit të malit, i cili tregëtohet në vendet fqinje, grumbullimi i bimëve mjekësore nuk bëhet nga popullata për shkak të një serie problemesh si, mungesa e një pike grumbullimi, fitime të ulëta nga shitja etj. Aktualisht, grumbullimi dhe tregëtimi i bimëve mjekësore mbetet një potencial i humbur. Rivitalizimi i një aktiviteti të tillë do të kërkojë edhe aftësimin e popullatës lokale për vjeljen e tyre në mënyrat e duhura, me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë mjedisore.

Ashtu siç u theksua më sipër, **Parku natyror** është elementi mbi të cilin ndërtohet konteksti ekonomik i bashkisë dhe mirëqënia e banorëve varet nga menaxhimi i qëndrueshëm i tij. Grupe të ndryshme të popullatës lokale, si fermerët, bletërritësit, bizneset turistike, blegtorët, etj të gjithë aktivitetin e tyre e kanë të lidhur me Parkun. Përfitimet e tyre rriten me mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të tij. Si rrjedhim, menaxhimi i parkut nuk shihet i ndarë nga banorët lokalë të cilët përbëjnë pjesën integrale të kësaj pasurie natyrore. Popullsia lokale përfaqëson një aktor të rëndësishëm në mbrojtjen e natyrës, ndaj ata duhet të ndërgjegjësohen për vlerat e zonave natyrore të komunitetit të tyre dhe për parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Menaxhimi i qëndrueshëm i Parkut duhet të kthehet në një traditë që trashëgohet brez pas brezi për banorët e bashkisë së Pustecit.

Mbështetje për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm duhet të ofrohet dhe promovohet në territoret target të Parkut sipas legjislacionit. Zhvillimi i turizmit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i

<sup>7</sup> Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, Komuna Liqenas (2007)

<sup>8</sup> Po aty

<sup>9</sup> Po aty



parkut shihet të lidhura ngushtë. Krijimi i itinerareve turistike në zonë dhe promovimi i turizmit do të gjenerojnë të ardhura që kanë potencialin për t'u kthyer në paketa financiare për mbrojtjen e parkut dhe projekte të ndryshme zhvillimore. Pusteci ka potencialin për të qenë zonë e mbrojtur me kapacitet turistik.

## 4.5 Shërbimet publike dhe infrastruktura

### 4.5.1 Edukimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive

Përsa i përket shërbimeve bazë si edukimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive ato më së shumti janë të lokalizuara në Pustec që përfaqëson edhe qendrën administrative, sociale dhe kulturore të jetës komunitare.

Aktualisht, funksionojnë 2 shkolla nëntëvjeçare në Pustec dhe Goricë e Madhe, të cilat frekuentohen nga një numër prej 147 nxënësish. Stafi edukues përfshin 27 mësues. Ndërsa në fshatrat e tjerë funksionojnë 6 shkolla të ciklit të ulët. Arsimi parashkollor ofrohet në shumicën e fshatrave të bashkisë. Në total ka 5 koshte. Numri i fëmijëve që frekuentojnë këto kopshte është 75 fëmijë dhe stafi edukativ 6. Ndërsa, arsimi i mesëm ofrohet nga një shkollë e mesme e përgjithshme, e cila ndodhet në qendrën e bashkisë. Numri i nxënësve është i ulët, vetëm 27 dhe stafi mësimor 6. (Shih Anekse, Tab.nr.4). Edukimit sportiv të fëmijëve i shërben dhe fusha sportive e ndërtuar viteve të fundit për fëmijët në Pustec.

Ka një përmirësim të dukshëm të infrastrukturës së shkollave duke bërë që ato të funksionojnë më mire dhe të ofrojnë kushte më të mirë mësimdhënie. Ato janë furnizuar me të gjitha materialet e nevojshme. Ndërhyrje rehabilituese ka pasur në godinat e shkollave në fshatin Tuminec, Leskë dhe Shulin. Ndërkohë, shkollat luajnë rol të rëndësishëm në lidhje me promovimin e vlerave të spikatura natyrore të zonës. Në ambjentet e shkollës së mesme janë ekspozuar të dhëna për pasuritë natyrore të bashkisë.

Aktualisht ekziston një ndërveprim i rritur social dhe shkëmbime tregëtare dhe kulturore ndërmjet Bashkisë dhe komunave fqinje maqedonase. Këto shkëmbime lehtësohen edhe nga ndërtimi dhe funksionimi i pikës së kalimit kufitar Stenje-Goricë, e ndërtuar viteve fundit si dhe nga infrastruktura rrugore e përmirësuar nga kufiri deri në qytetin e Korcës. Në kuadër të këtyre ndërveprimeve edukuese dhe kulturore, një numër i konsiderueshëm i studentëve dhe nxënësve kanë përfituar bursa për të studiuar në Maqedoni. Gjithashtu, me synimin e forcimit të lidhjeve shpirtërore dhe afrimit me kulturën dhe shtetin e tyre amë, Maqedoninë, bashkia organizon edhe vizita, ekskursione për pensionistë, gra e fëmijë nga Pusteci.

Në lidhje me shërbimin shëndetësor, ai ofrohet nga 2 qendra shëndetësore dhe 4 ambulanca të shpërndara nëpër fshatra. Dy mjekë, 15 infermiere dhe mami përbëjnë stafin që ofron shërbimin mjekësor. (Shih Anekse, Tab.nr.4).

Aktualisht ka një axhendë të pasur me festa lokale të cilat janë kryesisht nacionale maqedonase dhe ortodokse, për shkak të përkatësisë etnike dhe fetare të popullatës. Këtu përmendim Ditën e Shën Mëhillit (21 nëntor), e Shën Thanasit (31 Janar) etj. Rishtas në bashki janë organizuar Festivali Folklorik maqedonas PRESIPA, një festë që afirmon kulturën, këngët dhe vallet maqedonase; Festën nacionale maqedonase “2 Gushti” – që përfaqëson ditën e formimit të shtetit të Maqedonisë – ILINDEN; festa e 24 Majit, dita e rilindasve maqedonasë, të vëllezërve Shën Cirili dhe Metodi.

#### 4.5.2 Furnizimi me ujë të pijshëm

Për shkak të zonës në të cilën shtrihet territori i bashkisë - masive të gurit qëlqeror - burimet natyrore të ujit të pijshëm janë shumë të rrallë. Vetëm tre fshtara furnizohen me ujë të pijshëm, edhe pse me kufizim, nga burime natyrore me rrjedhje të lirë. Në bashki funksionojnë 4 sisteme ujësjellësash, të cilat janë sisteme me rrjedhje të lirë. 2 prej tyre i shërbejnë popullatës në Pustec, 1 në Kallamas dhe 1 në Lajthizë. (Shih Anekse, Tab.nr.3). Fshatrat e tjerë të bashkisë furnizohen me ujë të pijshëm nga ujërat e Liqenit, të cilat merren me pompa dhe grumbullohen në depo uji në zona dominuese në fshat, nga ku shpërndahet nëpërmjet tubacioneve të ujësjellësave. Megjithatë, gjithnjë e më shumë bëhet e vështirë thithja e ujit të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e popullsisë. Kjo për shkak të thatësisë që shkakton uljen e nivelit të ujërave në liqen. Alternativa për të siguruar furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës është realizimi i shpimeve në thellësi në kërkim të burimeve të reja nga ujërat nëntokësorë. Hartimi i projekteve teknike për ndërtimin e ujësjellësave për çdo fshat të bashkisë, gjetja e financimeve dhe zbatim i tyre përbën një prioritet afatshkurtër për administratën e bashkisë për të furnizuar me ujë të rrjedhshëm higjenikisht të pastër popullatën lokale, si kusht për zhvillimin ekonomik, me fokus të veçantë në zhvillimin e turizmit.

#### 4.5.3 Kanalizimet e ujërave të zeza

Ashtu si ujësjellësi, edhe KUZ-të përbëjnë çështje prioritare për ndërhyrje duke patur parasysh zhvillimin e turizmit në të ardhmen. Së pari, duhet që shërbimet publike të përmbushin nevojat e popullsisë rezidente dhe në të ardhmen të munden të përballojnë kërkesën e rritur nga turistët dhe vizitorët. KUZ-të marrin rëndësi të veçantë nëse merret në konsideratë edhe pozicioni i shtrirjes së fshatrave të bashkisë. Këto sisteme KUZ që duhet të ndërtohen për të gjitha fshatrat (vetëm 2 prej tyre, Liqenas dhe Zaroshkë kanë), duhen ndërtuar të tilla që respektojnë standartet e përcaktuara. Pajisja me kolektorë për grumbullimin dhe trajtimin paraprak të ujrave para se ato të derdhen në Liqen është një domosdoshmëri për mbrojtjen e liqenit nga ndotja.

#### 4.5.4 Mbetjet urbane

Mbetjet në Pustec gjenerohen kryesisht nga familjet dhe bizneset e vogla të cilat realisht janë të kufizuara në numër. Për shkak të dobësive që shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ka, ato përbëjnë edhe burimin kryesor të ndotjes së ambjentit. Mungesa e pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe përpunimit të tyre, mos grumbullimi dhe transportimi i tyre janë disa prej problemeve. Gjithashtu, venddepozitimi i mbetjeve duhet të jetë jashtë pellgut ujëmbledhës të liqenit, për të shmangur ndotjen e ujrave të liqenit nga infiltrimet e mundshme. Vetëm në dy fshatrat e bashkisë ka pika grumbullimi. Gjithashtu, bashkia ka siguruar dy kamione për mbledhjen e mbeturinave.

Kërkesa e rritur për një shërbim efektiv të menaxhimit të mbetjeve lidhet ngushtë me zhvillimin e turizmit dhe vlerat natyrore të parkut. Cënimi i ofrimit të këtij shërbimi, dëmton dhe ul vlerat e pasura natyrore dhe turistike që ka Pusteci. Ndërsa rezultati final do të ishte kompromentimi i zhvillimit të qëndrueshëm.

## 4.6 Përfundime

Territori i bashkisë përkon me pellgun ujëmbledhës të liqenit të Prespës, i cili ka statusin e Parkut Kombëtar të Prespës, zonë e mbrojtur në nivel ndërkombëtar. Kjo bashki popullohet nga minoriteti etnik maqedonas të cilët janë të integruar në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit. Popullata lokale karakterizohet nga ndërveprime sociale, kulturore dhe ekonomike intensive me Republikën e Maqedonisë.

Ndarja administrative territoriale në këtë bashki nuk krijon probleme për shkak se ruhet e njëjta hapësirë gjeografike. Pra, adresimi i çështjeve që gjeneron konsolidimi territorial si rezultat i reformës administrative dhe territoriale nuk janë relevante në bashkinë e Pustecit. Gjithsesi, bashkia përballlet me sfida që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve persistente. Një ndër to është edhe ngritja dhe mirëmbajtja e një rrjeti të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, si dhe menaxhimi i mbetjeve urbane në mënyrë që të evitohet ndotja e zonave të banuara por dhe ujërave që derdhen në Liqenin e Prespës.

Popullsia karakterizohet shumë homogjene përsa i përket përkatësisë etnike dhe fetare. Ajo është maqedonase dhe e besimit fetar ortodoks. Popullsia dominohet nga grupmosha 15-64 vjeç, e cila përfaqëson forcën aktive të punës të popullatës lokale. Ndërsa popullsia e moshës së re është e ulët. Ndryshimet demografike të popullsisë paraqesin një trend të qëndrueshëm, pa ulje ngritje të forta, duke mos krijuar në këtë mënyrë presione zhvillimore.

Përsa i përket shërbimeve bazë si edukimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive ato më së shumti janë të lokalizuara në Pustec që përfaqëson edhe qendrën administrative, sociale dhe kulturore të jetës komunitare. Aktualisht ekziston një ndërveprim i rritur social dhe shkëmbime tregëtare dhe kulturore ndërmjet Bashkisë dhe komunave fqinje maqedonase. Këto shkëmbime janë lehtësuar nga ndërtimi dhe funksionimi i pikës së kalimit kufitar Stenje-Goricë.

Përmirësimi i infrastrukturës lidhëse rurale do të rrisë kohezion social të komunitetit në bashki dhe nga ana tjetër do të rrisë aksesin në shërbimet bazë. Impakt pozitiv do të ketë edukimi nëpërmjet rritjes së frekuentimit të shkollës së mesme në Pustec. Aktualisht, infrastruktura e dobët rrugore lidhëse ndikon negativisht në frekuentimin e shkollës së mesme nga nxënësit e fshtarave të bashkisë, në kushtet kur transporti publik, apo i nxënësve nuk ofrohet.

| <b>9</b> | <b>Lajthize</b>       |                                   | <b>Po</b>                         | <b>1</b>                           | <b>1</b>                      |

Tabela 3: të dhëna për rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm (Bashkia Pustec 2015)

| Njesite administrative | Nr. shkollave 9-vjecare | Nr. nxenes | Nr. mesues | Nr. shkollave te mesme | Nr. nxenes | Nr. mesues | Nr. kopshte | Nr. femijev e | Nr edukat |
|------------------------|-------------------------|------------|------------|------------------------|------------|------------|-------------|---------------|-----------|
| <b>Pustec</b>          | 1                       | 80         | 13         | 1                      | 27         | 6          | 1           | 31            | 2         |
| <b>Gorice e Vogël</b>  | 1                       | 67         | 14         | -                      | -          | -          | -           | -             | -         |
| <b>Kallamas</b>        | -                       | -          | -          | -                      | -          | -          | 1           | 17            | 1         |
| <b>Goricë e Madhe</b>  | -                       | -          | -          | -                      | -          | -          | 1           | 10            | 1         |
| <b>Lajthize</b>        | -                       | -          | -          | -                      | -          | -          | 1           | 5             | 1         |
| <b>Diellas</b>         | -                       | -          | -          | -                      | -          | -          | 1           | 12            | 1         |

Tabela 4: të dhëna për infrastrukturën arsimore (bashkia Pustec 2015)

| Fshatrat              | Fushë (ha)   | Kodër (ha) | Mal (ha)  |
|-----------------------|--------------|------------|-----------|
| <b>Pustec</b>         |              |            |           |
| <b>Goricë e Vogël</b> | 66,28        | 20         | <b>10</b> |
| <b>Goricë e Madhe</b> | 100          | 56,28      | <b>60</b> |
| <b>Kallamas</b>       | 124,55       | 40         | <b>30</b> |
| <b>Gollomboc</b>      | <b>20,25</b> | <b>53</b>  | <b>30</b> |

Tabela 5: Struktura e sipërfaqes së tokës (bashkia Pustec 2015)

| Fshatrat              | Tokë Bujqësore (ha) |              |              |             | Pyje (ha)  | Livadhe kullota (ha) | Te tjera |
|-----------------------|---------------------|--------------|--------------|-------------|------------|----------------------|----------|
|                       | Ara (ha)            | Pemishte(ha) | Ullishte(ha) | Vreshta(ha) |            |                      |          |
| <b>Pustec</b>         | 228,72              | 14,94        | -            | 26,09       | 484        |                      |          |
| <b>Lajthize</b>       | 71,82               | 3,55         | -            | -           | 129        | -                    | -        |
| <b>Zaroshke</b>       | 106,75              | 6,64         | -            | 9,15        | 357        | -                    | -        |
| <b>Cerje</b>          | 174,17              | 3,87         | -            | -           | 129        | --                   | -        |
| <b>Diellas</b>        | 125,02              | -            | -            | 1,82        | 530        | -                    | -        |
| <b>Gorice e Vogel</b> | 79,88               | -            | -            | 14,90       | 262        | -                    | -        |
| <b>Gorice e Madhe</b> | 208,45              | 0,10         | -            | 2,47        | 329        | -                    | -        |
| <b>Kallamas</b>       | 177,77              | -            | -            | 9,88        | 809        | -                    | -        |
| <b>Gollomboc</b>      | <b>82,14</b>        | <b>14,58</b> | -            | <b>1,08</b> | <b>711</b> | -                    | -        |

Tabela 6: struktura e sipërfaqes së tokës bujqësore (Bashkia Pustec, 2015)

| Njësitë administrative | Drithera |           |            | Produkte bujqesore |           |            | Fruta (t) | Vresht (t) |
|------------------------|----------|-----------|------------|--------------------|-----------|------------|-----------|------------|
|                        | Grure(t) | Miser (t) | Theker (t) | Te ndryshme (t)    | Patate(t) | Fasule (t) |           |            |
| Pustec                 | 132      | 50        | -          | 30,8               | 10        | 7,69       | 14,96     | 25,80      |
| Diellas                | 90       | 15        | 10         | 4                  | 1         | 20         | -         | 182        |
| Lajthize               | 42       | 15        | 3,59       | 1,23               | -         | 10         | 3,59      | -          |
| Zaroshke               | 77       | 13        | 2          | 8,87               | 0,98      | 9          | 6,64      | 5,05       |
| Cerje                  | 50       | -         | 20         | 68,97              | -         | -          | 3,87      | -          |
| Gorice e Vogël         | 40,98    | 10        | 2          | 10                 | 0,5       | 5          | 14        | 18,80      |
| Gorice e Madhe         | 120      | 35        | 5          | 20,3               | 5         | 30         | -         | 0,70       |
| Kallamas               | 110      | 25        | -          | 15,37              | 3         | 35         | -         | 6,18       |
| Gollomboc              | 50       | 10        | -          | 6,9                | 1         | 10         | 14,50     | 10,80      |

Tabela 7: Prodhimtaria bujqësore (Bashkia Pustec, 2015)

| Fshatrat       | Të imta |     | Gjedhë | Shpendë |
|----------------|---------|-----|--------|---------|
|                | Dele    | Dhi |        |         |
| Pustec         | 430     | 230 | 520    | 1200    |
| Lajthize       | 30      | 100 | 120    | 300     |
| Zaroshke       | 70      | -   | 125    | 400     |
| Cerje          | 220     | -   | 25     | 120     |
| Diellas        | 10      | 350 | 315    | 550     |
| Gollobmoc      | -       | 30  | 125    | 350     |
| Gorice e Vogel | 500     | -   | 210    | 360     |
| Gorice e Madhe | 700     | 210 | 335    | 900     |
| Kallamas       | 500     | 150 | 350    | 700     |

Tabela 8: të dhëna për blegtorinë sipas fshatrave (Bashkia Pustec, 2015)

|                                       | gjithsej | meshkuj | femra |
|---------------------------------------|----------|---------|-------|
| <b>pa aftësi të kufizuara</b>         | 2579     | 1372    | 1207  |
| <b>me aftësi të kufizuara</b>         | 231      | 92      | 139   |
| <b>Gjithsej popullsia &gt;15 vjec</b> | 2810     | 1464    | 1346  |

Tabela 9: Popullsia banuese >15 vjec sipas gjinisë dhe gjendjes së aftësisë (INSTAT, Census 2011)

## **Projekfishat**

- 1. Rehabilitimi i shkollës së bashkuar në Pustec**
- 2. Programi i trajnimit të administratës së Bashkisë Pustec për t'ju përgjigjur zhvillimeve social ekonomike të zonës**
- 3. Mbështetje e integruar për mbrojtjen, promovimin dhe zhvillimin e bimëve etoreovajore dhe medicinale në bashkinë Pustec**
- 4. Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Glloboçan**
- 5. Asfaltimi i rrugës lidhëse nga rruga kryesore deri në Glloboçan**
- 6. Promovimi, krijimi dhe mbështetja e grupeve lokale të veprimit**
- 7. Krijimi i transportit të rregullt për fëmijët e Goricës së Madhe, Tuminecit dhe Glloboçenit për të shkollat në Goricën e Vogël dhe shkollat Pustec**
- 8. Sistemin e përroit të Pustecit**
- 9. Ndërtim rruge me kalldrëm në Liqenas**
- 10. Asfaltimi i rrugës lidhëse së fshatit Goricë e Vogël**
- 11. Trajnimi i punonjësve të administratës vendore për një menaxhim të integruar të mbetjeve urbane**

|   |  |
|---|--|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Rehabilitimi i shkollës së bashkuar në Pustec</b>   |
| Tipi i Projektit  | Infratrakturë arsimore   |
| Vendndodhja e projektit                                     | Fshati Pustec, Bashkia Pustec  |
| Buxheti total i projektit                                   | <b>22,669,074 Lekë</b>   |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | 5%   |
| Përshkrimi i Projektit                                      | <p>Shkollat e mesme e bashkuar në Pustec përfaqëson jo vetëm një institucion arsimor, por për vetë vendndodhjen, rolin që luan në zhvillimin e komunitetit dhe hapësirat fizike që ka, është një institucion qendror i zhvillimit komunitar për gjithë popullsinë lokale të bashkisë Pustec.</p> <p>Shkolla është një ndërtesë 2 katëshe. Kushtet teknike të godinës së shkollës janë të këqija, mure me lagështi, dyer e dritare të dëmtuara etj. Kjo situatë bën që zhvillimi i procesit mësimor të bëhet në kushte shumë të vështira. Në këtë kontekst, në kushtet kur kërkesat më minimale për zhvillimin e mësimin nuk plotësohen si infrastruktura fizike e dobët, dëmton procesin e mësimin, duke ulur ndjeshëm frekuentimin e procesit mësimor nga ana e nxënësve. Aktualisht, numri i nxënësve në këtë shkollë arrin në 110 nxënës, në arsimin e mesëm numri i tyre është tejet i ulët, vetëm 27 nxënës dhe stafi mësimor përfshin vetëm 6 mësues.</p> <p>Objekti i shkollës së mesme të bashkuar në Pustec është rehabilituar në vitin 2003, por pjesërisht. Ndaj Projekti për rikonstruksionin e shkollës përfshin rikonstruksionin e plotë të godinës dhe sistemimi i oborrit rrethues gjithashtu.</p> <p>Duke marrë në konsideratë se shkolla e mesme e Pustecit është e vetmja shkollë ku ofrohet mësim i mesëm, Përfituesit e drejtëpërdrejtë të këtij projekti është e gjithë popullata lokale në Pustec, rreth 5345 banorë. Ky numër i lartë përfituesish rezulton edhe nga roli kryesor që kjo shkollë luan në jetën komunitare të Pustecit.</p> |
| Qëllimi dhe Objektivat                                      | Projekti synon në përmirësimin e infrastrukturës fizike të shkollës së mesme të Bashkuar në Pustec si një mënyrë për të rritur frekuentimin e shkollës dhe rezultatë më të mira të arritura nga nxënësit e kësaj shkolle.  |
| Rezultatet e Pritshme                                       | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ambiente dhe kushte për mësimdhënie bashkëkohore;</li> <li>2. Motivim dhe interes i rritur për procesin mësimor nga stafi mësimor dhe nxënësit;</li> <li>3. Siguri dhe mbarëvajtje e procesit mësimor e përmirësuar;</li> <li>4. Frekuentim dhe vijueshmëri e rritur në procesin mësimor;</li> <li>5. Infrastrukturë shkollore gjithëpërfshirës për nxënësit me aftësi të kufizuara;</li> <li>6. Rezultate të përmirësuara në mësim.</li> </ol>  |
| Rendi Prioritar   | Nr. 2  |
| Qëndrueshmëria e Projektit                                  | Bashkia Pustec do të garantojë koston për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij, e cila do të planifikohet në buxhetin e Bashkisë. Gjithashtu, vetë komuniteti i nxënësve dhe gjithë popullata lokale do të angazhohen në mirëmbajtjen e saj.  |
| Aktivitetet e Projektit                                     | Aktivitetet e projektit janë specifikuar në projektin e zbatimit dhe 43 specifikimet teknike. Kryesisht ndërhyrja do të përfshijë punime   |

|   |   |
|---|---|
|   | muratorie, subvatime, lyerje muresh, riparim catisë, vendosje të dyerve dhe dritareve, sistemim i oborrit,etj.  |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                    | Nuk ka një studim VNM-je.   |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Projekti është i gatshëm për zbatim.<br>Nga Bashkia do të merren masa që periudha e rikonstruktionit të mos pengojë procesin mësimor, duke zgjedhur periudhë zbatimi të projektit periudhën e verës, ose do të sigurojë ambiente alternative për zhvillimin mësimor, gjatë kohës së zbatimit të punimeve. |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar          | Projekti është pjesë e programit të Kryetarit të bashkisë, vendimeve të prioriteteve të Këshillit Bashkiak, dhe pjesë e Planit Operacional të ZHvillimit Lokale për bashkinë Pustec.  |

|   |   |
|---|---|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Programi i trajnimit të administratës së Bashkisë Pustec për t'ju përgjigjur zhvillimeve social ekonomike të zonës</b>   |
| Tipi i Projektit  | Administratë Publike  |
| Vendndodhja e Projektit                                     | Bashkia Pustec  |
| Buxheti total i Projektit                                   | 1,000,000 lekë (aplikime pranë organizatave të ndryshme që operojnë në këtë fushë)  |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor  |
| Përshkrimi i projektit                                      | Një nga prioritetet në planin strategjik është evidentuar forcimi i kapaciteteve të administratës publike për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarit, ofrimin sa më cilësor të shërbimeve publike dhe aftësimi i tyre për zbatimin e koncepteve të zhvillimit ekonomik lokal, menaxhimin e projekteve, etj. Është konstatuar se Administrata vendore ka mangësi në kryerjen e shërbimeve cilësore dhe në stafe të kualifikuara dhe trajnuara. Për më tepër, për vetë tiparet që e karakterizon territorin lokal, zonë e mbrojtur me pasuri të jashtëzakonshme të burimeve natyrore, është nevojë e fortë ekspozimi fillimisht i administratës me koncepte të zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit vendor të drejtuar nga komuniteti. Stafi i aftësuar i administratës mund të transferojë këto aftësi te komuniteti gjatë punës. |
| Qëllimi dhe Objektivat                                      | Objektivi i projektit është përmirësimi i performancës së punës së administratës lokale në Bashkinë Pustec nëpërmjet rritjes së njohurive teknike dhe aftësive praktike në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik në nivel vendor<br>Qëllimi specifik i projektit është trajnimi dhe kualifikimi i punonjësve të administratës lokale dhe përshtatja e tyre me metoda dhe eksperiencia pozitive në vend dhe rajon sipas pozicioneve të punës.   |
| Rezultatet e Pritshme                                       | Rritja e njohurive teknike dhe aftësive praktike për zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik; aplikimi i njohurive dhe aftësive gjatë punës në administratë; Rritje e motivimit të punonjësve; Rritje e efektivitetit dhe efencës në punë;   |
| Rendi Prioritar   | Nr.9  |
| Qëndrueshmëria e Projektit                                  | Pritet që pas trajnimit, punonjësit të aplikojnë njohuritë e marë dhe aftësitë e fitura në punë dhe t'i ndajnë ato me kolegë të tjerë të administratës.   |
| Aktivitetet e Projektit                                     | 1. Analizë e nevojave të trajnimit- Ngritja e grupit të punës për të hartuar një vlerësim nevojash të punonjësve në Bashkinë e Pustecit. Grupi do të formulojë një pyetësor për të matur kapacitetet dhe nevojat e ndryshme për trainim të stafeve.<br>2.Hartimi i moduleve të trajnimit -Bazuar në rezultatet e marra do të hartohet një plan veprimi për kryerjen e trainimeve. Modulet e temave përkatëse do të hartohen nga trajnues të kualifikuar bazuar në përmbushjen e kërkesave të stafeve për trainim dhe njëkohësisht të integruara me zhvillimet dhe kërkesat për një administratë të kualifikuar.<br>3.Zhvillimi i Trajnimeve - Trainimet do të jenë të zhvilluara në formën e një moduli disa ditor dhe çështje të ndryshme do të trajtohen duke   |



|   |  |
|---|--|
|   | qenë komplementare ndërmjet tyre dhe ofruar një gamë të gjerë informacioni për stafet e NJQV-ve. |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                    | NA   |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Programi i Trajnimit është i gatshëm për zbatim  |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar          | Programi i Trajnimit është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal, bashkia Pustec.       |

|   |  |
|---|--|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Mbështetje e intergruar për mbrojtjen, promovimin dhe zhvillimin e bimëve eterojavore dhe medicinale në bashkinë Pustec</b>   |
| Tipi i Projektit  | Zhvillimi Ekonomik   |
| Vendndodhja e Projektit                                     | Bashkia Pustec   |
| Buxheti total i Projektit                                   | 1,700,000 lekë (mbështetje nga MBZHRAU; skemat e kreditimit në bujqësi, si dhe parteneritet public privat)   |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor   |
| Përshkrimi i projektit                                      | Nisur nga fakti që territori i bashkisë përkon me pellgun ujëmbledhës të liqenit të Prespës, i cili ka statusin e Parkut Kombëtar të Prespës, zonë e mbrojtur në nivel ndërkombëtar, në këtë territor gjenden pasuri të shumta natyrore. Bimët mjekësore përfaqësojnë një nga këto pasuri natyrore të zonës. Në territor gjen një shumëllojshmëri të madhe të tyre. Nga studime të ndryshme janë evidentuar rreth 330 dhe 220 lloj bimësh mjekësore dhe eterovajore. Grumbullimi i këtyre bimëve ka qenë aktivitet ekonomik i popullatës lokale para viteve 90. Por në ditët e sotme, vetëm çaji i malit grumbullohet dhe tregëtohet në vendet fqinje. Popullata lokale nuk është e angazhuar në këtë aktivitet ekonomik për shkak të interesit të ulët që vjen si pasojë e mungesës së infrastrukturës grumbulluese të tyre, fitime të ulëta nga shitja e tyre, etj. Duke e kthyer grumbullimin dhe tregëtimin e bimëve mjekësore në një potencial të humbur. Rivitalizimi i një aktiviteti të tillë do të kërkojë edhe aftësimin e popullatës lokale për vjeljen e tyre në mënyrat e duhura, me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë mjedisore, por edhe krijimin e infrastrukturës grumbulluese si dhe gjetjen e tregjeve. |
| Qëllimi dhe Objektivat                                      | Objektivi i projektit është rritja e të ardhurave lokale nëpërmjet shfrytëzimit në mënyrë të qëndrueshme të bimëve mjekësore eterovajore e tanifere.<br>Objektivat specifik të projektit: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytëzim në mënyrë të qëndrueshme të bimëve mjekësore eterovajore e tanifere</li> <li>• Evidentimi i plotë i bimëve MET dhe promovimi i tyre;</li> <li>• Ndergjegjesimi dhe edukimi i komunitetit</li> <li>• Sigurimi i infrastrukturës fike për grumbullimin dhe tharjen e tyre</li> </ul>   |
| Rezultatet e Pritshme                                       | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Burimet natyrore të mirëmenaxhura në funksion të rritjes së të</li> </ul>   |

|   |  |
|---|--|
|   | <p>ardhurave të popullatës lokale;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bimët MET janë mbrojtur, menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe promovuar;</li> <li>• Angazhimi i popullatës në këtë sektor është rritur</li> <li>• Të ardhurat e familjeve dhe bizneset e bimëve MET janë rritur.</li> </ul>  |
| Rendi Prioritar                                   | Nr.7   |
| Qëndrueshmëria e Projektit                        | Njohuritë praktike, teknikat e përfuara në grumbullimin e bimëve MET, rezultatet e edukimit të popullatës lokale do të trashëgoohen mes brezave duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e projektit por edhe të zhvillimit lokal në lidhje me bimët MET.  |
| Aktivitetet e Projektit                           | <p>Kjo projektfishë intergon disa ide projektesh në lidhje me bimët MET, të cilat janë përfshirë në matricën e zhvillimit ekonomik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Krijimi i materialeve promovuese, ndërjegjësuere për bimët MET që rriten në zonën e Parkut</li> <li>➤ Shfrytëzimi i kontrolluar e në përputhje me teknikën e rekomanduar të këtyre bimëve nëpërmjet ëorkshopeve me popullsinë lokale</li> <li>➤ Mbjellja e tokave djerrë me bimë MET dhe kultura të tjera të përshtatshme</li> <li>➤ Hapja e një pikë grumbullimi të bimëve MET në Prespën e Vogël</li> </ul> |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                    | I gjithë koncepti për këtë program lidhet dhe bazohet të sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore, ndikimi në mjedi do të jetë vetëm pozitiv dhe i shërben ruajtjes së mjedisit  |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Bashkia duhet të krijojë një grup me natyrë pjesëmarrëse (staf i bashkisë, komunitetit dhe biznesi lokale, studiues dhe ambientalist) për të realizuar analizat paraprake të këtij programi.   |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar          | Ky program është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal, bashkia Pustec.   |

|   |  |
|---|--|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Glloboçan</b>  |
| Tipi i Projektit  | Infrastrukturë Ujësjellës  |
| Vendndodhja e Projektit                                     | Fshati Glloboçan   |
| Buxheti total i Projektit                                   | 14,524,960 Lekë  |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor   |
| Përshkrimi i Projektit                                      | Për shkak të terrenit në të cilën shtrihet territori i bashkisë - masive të gurit qëlqeror - burimet natyrore të ujit të pijshëm gjenden shumë rrallë. Ndërkohë që gjithnjë e më shumë vihet re tharrja e burimeve natyrore të ujit. Këto të dhëna konstatojnë vështirësinë që ka popullata lokale në bashki për të siguruar ujin e pijshëm duke i kthyer ndërtimin e ujësjellësave në një prioritet të zhvillimit të zonës. Vetëm një pjesë shumë e vogël e fshatrave furnizohen me ujë të pijshëm, edhe pse me kufizim, nga burime |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>natyrore me rrjedhje të lirë.</p> <p>Në fshatin Gllloboçan është realizuar shpimi në thellësi për të gjetur ujë, i cili ka qenë rezultativ. Burimi i ujit i gjetur duhet të vihet në dispozicion të banorëve nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit që të jetë i përdorshëm. Sigurimi i ujit të pijshëm, higjenikisht të pastër 24 orë për popullsinë lokale përbën një prioritet që duhet adresuar sa më shpejt jo vetëm për të përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë, por edhe si kusht për zhvillimin ekonomik ku tendenca është për zhvillimin e turizmit familjar.</p> <p>Me këtë synim duhe të hartohet dhe të zbatohet projekti i ndërtimit të ujësjellësit të fshatit Gllloboçan.</p> <p>Projekti do të specifikohet në projektin teknik por përgjithësisht, projekte të tilla përfshijnë punime gërmimi, shtrirje tubacioni, shtrirje e rrjeteve të brendshme, punime sistemimi të tubacionit, punime rrethimi në veprën e marrjes së ujit, ndërtim pusetash të ndryshme si ajrosje, shkarkimi, shpërndarje, ndërtim i depos së re të ujit, lidhjet e banesave në rrjetin e ujësjellësit, vendosjen e matësve të ujit.</p> <p>Përfituesit e drejtëpërdrejtë të këtij projekti do të jenë banorët e fshatit Gllloboçan. Ndërsa përfitues indirekt përfshijnë edhe turistët dhe vizitorë, të cilët në janë gjithnjë e në rritje viteve të fundit.</p> |
| Qëllimi dhe Objektivat                            | Projekti synon të furnizojë popullsinë e fshatit Gllloboçan me sasi të mjaftueshme uji të pastër higjenikisht dhe në mënyrë të pandërprerë nëpërmjet ndërtimit të ujësjellësit.   |
| Rezultatet e Pritshme                             | Infrastrukturë teknike dhe funksionim i përmirësuar i furnizimit me ujë të pijshëm; Furnizim i pandërprerë me ujë të pastër higjenikisht; rritje e nivelit të shërbimeve publike si qendra spitalore, qendra arsimore apo në sektorin e biznesit; përmirësim cilësor i kushteve të jetesës.   |
| Rendi Prioritar                                   | Nr.3  |
| Qëndrueshmëria e projektit                        | Pas investimit, ujësjellësi do të kalojë nën administrimin e Bashkisë Pustec, si pjesë e kompetencave të qeverisjes vendore   |
| Aktivitetet e projektit                           | Për t'u përcaktuar në projektin teknik  |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                    | Nuk ka një VNM të detajuar, por ndikimi do të jetë minimal. Pas ndërtimit të ujësjellësit do të punohet për të mbuluar rrjetin dhe kanalet e hapura.  |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Projekti është i gatshëm për zbatim. Nga Bashkia do të merren masa për sistemimin e kantierit të ndërtimit i cili është pronë publike.  |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar          | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal.  |

|   |  |
|---|--|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Asfaltimi i rrugës lidhëse nga rruga kryesore deri në Gllloboçan</b>  |
| Tipi i Projektit  | Infrastrukturë rrugore   |
| Vendndodhja e projektit                                     | Fshati Gllloboçan, bashkia Pustec  |
| Buxheti total i Projektit                                   | 18,469,800 Lekë  |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor   |
| Përshkrimi i projektit                                      | <p>Territori i bashkisë ka një rrjet rrugor që nuk i përgjigjet zhvillimeve të ardhshme ekonomike, sidomos në lidhje me zhvillimin e turizmit. Edhe pse viteve të fundit janë bërë investime në rrjetin rrugor, kryesisht rrugës kryesore që përshkon territorin deri në pikën e kalimit kufitar me Republikën e Maqedonisë, rrugët e tjera që lidhin fshatrat me rrugën kryesore, si dhe rrugët e brendshme të fshatrave ende nuk janë të asfaltuara. Shumica e tyre janë të ngushta dhe nuk lehtësojnë lëvizjen e mjeteve dhe të banorëve. Gjithashtu, rrjeti rrugor lidhës me fshatrat dhe bregun e liqenit pothuajse është inekzistent. Para këtyre, prioritet është lidhja e fshatrave me rrugën kryesore për të rritur aksesin në shërbimet bazë dhe forcuar kohezionin social të bashkisë. Ky projekt synon të adresojë lidhjen rrugore të dobët të fshatit Gllloboçan me rrugën kryesore.</p> <p><b>Përfituesit e drejtëpërdrejtë</b> të këtij projekti janë banorët e fshatit Gllloboçan, ndërsa përfituesit indirekt janë dhe turistët dhe vizitorët që viteve të fundit kanë njohur rritje.</p> |
| Qëllimi dhe Objektivat                                      | Projekti ka si qëllim përmirësimin e aksesit në shërbimet bazë dhe rritjen e mundësive të zhvillimit ekonomik dhe bujqësor për banorët e fshatit Gllloboçan, nëpërmjet rikonstruksionit të rrugës që lidh këtë fshat me rrugën kryesore të bashkisë.   |
| Rezultatet e Pritshme                                       | Rritja e aksesit në shërbimet bazë dhe tregje; lehtësim i lëvizjes së njerëzve dhe produkteve lokale; rritje e nivelit të shërbimeve publike.  |
| Rendi Prioritar   | Nr.4   |
| Qëndrueshmëria e Projektit                                  | Rruga pas investimit do të mirëmbahet nga Bashkia Pustec, si pjesë e kompetencave vendore  |
| Aktivitetet e Projektit                                     | Hartimi i projektit teknik; Aplikimi për gjetje fondesh; Financimi; Prokurimi dhe zbatimimi i punimeve civile; Monitorimi i tyre; dorëzimi dhe mirëmbajtja në vazhdim të rrugës.   |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                              | I gjithë territori i bashkisë është zonë e mbrojtur. Nisur nga kjo cdo ndërhyrje infrastrukturore ka ndikime negative në mjedis që ka të bëjë me pluhura, zhurrma, prishja e pejsazhit etj. Duke pasur në konsideratë brishtësinë e zonës, do të hartohet plani I ndikimit në mjedis dhe si rrjedhi plani i masave zbutëse, për t'u zbatuar me rigorizitet nga të gjithë aktorët e përfshirë.  |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim           | Projekti është i gatshëm për zbatim. Nga Bashkia do të merren masa për lirimin e sheshit të ndërtimit i cili është pronë publike   |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar                    | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal.   |

|   |   |
|---|---|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Promovimi, krijimi dhe mbështetja e grupeve lokale të veprimit</b>   |
| Tipi i Projektit  | Zhvillimi rural, forcimi i kapaciteteve të administartës lokale   |
| Vendndodhja e Projektit                                     | Bashkia Pustec  |
| Buxheti total i Projektit                                   | 600,000 lekë  |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor  |
| Përshkrimi i projektit                                      | <p>Ekonomia lokale e bashkisë së Pustecit është tipike rurale dhe e gjithë hapësira territoriale e bashkisë është e tillë, rurale.</p> <p>Zhvillimi rural është një çështje prioritare përta i përket kapaciteteve njerëzore për të administruar fondet e BE-së në lidhje me zhvillimin rural. Në thelb të zhvillimit rural është qasja LEADER e promovuar nga BE, e cila propozon zhvillimin nga poshtë lart me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve lokal të cilët institucionalizojnë bashkëpunimin e tyre në një strukturë të quajtur LAG (Grupi Vendor i Veprimit). Kjo strukturë përfaqëson një partneritet trepalësh ndërmjet qeverisjes lokale, shoqërisë civile dhe biznesit. Rrjedhim i këtij partneriteti është strategjia e zhvillimit territorial. Ngritja, aftësimi i LAG-ut të Prespës dhe zhvillimi i strategjisë lokale janë prioritet për të marë avantazh nga fondet IPA (BE) që do të mbështesin zhvillimin rural të Shqipëri. Kusht i përfitimit nga këto fonde janë projekte të identifikuar dhe të përfshira në Strategjinë lokale të zhvillimit – strategji e hartuar dhe me pronësi të LAG-ut, pra Grupit Vendor te Veprimit.</p> <p>Si rrjedhim, promovimi i qasjes LEADER, krijimi dhe mbështetja e grupit lokal të veprimit (LAG-u i Prespës) merr rëndësi të vecantë në lidhje me zhvillimin rural të territorit nëpërmjet aksesimit në fondet e BE-së. LAG-u më pas duhet të formalizohet dhe të funksionojë si strukturë e natyrës mikes publike-private.</p> |
| Qëllimi dhe Objektivat                                      | <p>Qëllimi i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e zonës së Prespës nëpërmjet promovimit të qasjes LEADER (BE) në zhvillimit rural</p> <p>Qëllimi specifik i projektit është nxitja e partneritetit lokal tripalësh në nivel vendor për krijimin dhe funksionimin e LAG-ut të Prespës dhe krijimin e strategjisë lokale të zhvillimit</p>   |
| Rezultatet e Pritshme                                       | <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Kapacitete njerëzore të përgatitura dhe struktura të ngritura për të mundësuar përthithjen e fondeve të BE-së për zhvillimin rural</li> <li>➤ Krijimi dhe formalizimi i LAG-ut – bashkëpunim tripalësh në nivel vendor</li> <li>➤ Hartimi i Strategjisë lokale të Zhvillimit Rural;</li> <li>➤ Rritja e financimeve të projekteve që lidhen më përmirësimin e cilësisë së jetesës për banorët e zonës së Prespës</li> </ul>  |
| Rendi Prioritar   | Nr.10   |
| Qëndrueshmëria e Projektit                                  | Vetë parimet e qasjes LEADER që projekti përfshin, promovon qëndrueshmërinë e projektit. Kapacitet e ndërtuara, partneriteti  |

|  |  |
|--|--|
|  | tripalësh, strategjia dhe plani i veprimit për zhvillim rural dhe premtimi që e gjithë kjo iniciativë mban në lidhje me aksesimin e fondeve IPA (BE) për vendin tonë në fushën e zhvillimit rural në të ardhmen e bëjnë projektin tërësisht të qëndrueshëm.  |
| Aktivitetet e Projektit                  | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Promovimi i zhvillimit rural me pjesëmarrje nga poshtë-lart</li> <li>2. Sensibilizimi dhe trajnimi i fermerëve dhe aktorëve të tjerë privatë dhe publikë për funksionin e LAG-eve, nëpërmjet aktorëve që advokojnë zhvillimin rural sipas qasjes LEADER</li> <li>3. Identifikimi i fermerëve dhe subjekteve të tjerë iniciues të krijimit të LAG-ut;</li> <li>4. Formalizimi i LAG-ut, statuti dhe rregjistrimi sipas kornizës ligjore;</li> <li>5. Hartimi i Planit Operacional për vitet e para të të punës</li> <li>6. Ekspozimi ndaj eksperiencave të tilla pozitive në vend dhe rajon;</li> <li>7. Aktivitete planifikuese në lidhje me strategjinë e zhvillimit territorial</li> </ol> |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis           | NA   |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal, bashkia Pustec, pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural dhe Bujqësor 2015-2020.  |

|   |   |
|---|---|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Krijimi i transportit të rregullt për fëmijët e Goricës së Madhe, Tuminecit dhe Glloboçenit për të shkolla në Goricën e Vogël dhe shkolla Pustec</b>   |
| Tipi i Projektit  | Shërbim publik/arsimi   |
| Vendndodhja e Projektit                                     | Fshati Pustec dhe Gorice e Vogel  |
| Buxheti total i Projektit                                   | 500,000 lekë/vit  |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor  |
| Përshkrimi i projektit                                      | <p>Në bashkinë Pustec, shërbimet bazë si edukimi, shëndetësia dhe aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive më së shumti janë të lokalizuara në Pustec që përfaqëson edhe qendrën administrative, sociale dhe kulturore të jetës komunitare.</p> <p>Aktualisht, funksionojnë 2 shkolla nëntëvjeçare të cilat ndodhen në Pustec dhe Goricë e Vogël. Ndërsa, arsimi i mesëm ofrohet nga një shkollë e mesme e përgjithshme, e cila ndodhet në qendrën e bashkisë. Në këto kushte, fëmijët e fshatrave të tjerë frekuentojnë shkollën më të afërt nga fshati i tyre. Mirëpo, në kushtet kur transporti publik nuk ofrohet ose është i kufizuar dhe transporti i nxënësve nuk është adekuat, interesi për të frekuentuar procesin mësimor bie duke rezultuar në frekuentim të ulët të shkollës.</p> <p>Për të ndihmuar fëmijët e fshatrave të bashkisë të cilat nuk kanë shkollë (Goricë e Madhe, Tuminec, dhe Glloboçeni) që të frekuentojnë</p> |

|  |  |
|--|--|
|  | mësimin në shkollën nëntëvjeçare në Goricën e vogël dhe në Pustec, do të vendoset shërbimi i transportit.  |
| Qëllimi dhe Objektivat                   | Projekti synon në rritjen e aksesit në edukim për fëmijët e fsharave që nuk kanë shkollë nëpërmjet krijimit të transportit të rregullt. Kjo ndërhyrje është një mënyrë për të rritur frekuentimin e shkollës dhe për të arritur rezultate më të mira nga nxënësit.                               |
| Rezultatet e Pritshme                    | 7. Rritja e aksesit në shërbimin arsimor;<br>8. Motivim dhe interes i rritur për procesin mësimor nga nxënësit;<br>9. Frekuentim dhe vijueshmëri e rritur në procesin mësimor;<br>10. Rezultate të përmirësuara në mësim.  |
| Rendi Prioritar                          | Nr.5   |
| Qëndrueshmëria e Projektit               | Bashkëpunimi i autoriteteve lokale me biznesin lokal dhe komunitetin shihet si një mundësi për të siguruar fonde të mjaftueshme për mbulimin e kostos së këtij shërbimi.   |
| Aktivitetet e Projektit                  | Ndërgjegjësimi i komunitetit dhe biznesit lokal për rëndësinë e transportit të nxënësve në shkolla;<br>Alokimi i burimeve financiare për të siguruar një shërbim të tillë;<br>Prokurimi i shërbimit;<br>Lidhja e kontratës me firmën private;<br>Ofrimi i shërbimit dhe monitorimi i vazhdueshëm |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis           | Duke pasur në konsideratë faktin se territori i bashkisë është një Park natyror, projekti ka ndikim në mjedis, si pasojë e çlirimit të gazrave nga mjete për transport të nxënësve.  |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal, bashkia Pustec.   |

|   |  |
|---|--|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Sistemim i përroit të Pustecit</b>  |
| Tipi i Projektit  | Infrastrukturë mjedisore   |
| Vendndodhja e Projektit                                     | Fshati Pustec  |
| Buxheti total i Projektit                                   | 42,000,000 Lekë  |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor   |
| Përshkrimi i projektit                                      | Përroi i fshatit Pustec në kohën e prurjeve del nga shtrati dhe përmyt zonën e banuar të fshatit Pustec, i cili përfaqëson edhe qendrën social ekonomike të gjithë bashkisë. Përmytja shkakton shumë dëme te banorët për shkak se uji përmyt gjithë fshatin duke u futur edhe nëpër banesa, si dhe përmytur prodhimet bujqësore në fushat përreth. Gjithashtu, kjo situatë ndikon negativisht në ujrat e liqenit, duke shkakuar ndotje të urjave, për shkak të prurjeve të përroit në liqen. Kjo gjë është shkakuar nga një sërë problemesh që lidhen më hedhjen e mbeturinave nga banorët në shtratin e përroit, hedhjen e plehut të bagëtive. Gjithashtu, shtrati i përroit është ngushtuar për shkak të |

|  |  |
|--|--|
|  | ndërtimeve përgjatë segmentit që kalon nëpër fshat.  |
| Qëllimi dhe Objektivat                   | Projekti synon në përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët e fshatit Pustec nëpërmjet sistemimit të shtratit të përroit për evitimin e përmbytjeve.  |
| Rezultatet e Pritshme                    | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndalimi i përmbytjeve të zonës urbane në fshatin Pustec;</li> <li>2. Reduktimi i ndotjes së ujit të liqenit nga prurjet</li> <li>3. Parametra mjedisor të përmirësuar</li> <li>4. Toka të mbrojtura nga erozioni dhe përmbytjet</li> </ol> |
| Rendi Prioritar                          | Nr.1   |
| Qëndrueshmëria e Projektit               | Vetë natyra e projektit gjeneron qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura.  |
| Aktivitetet e Projektit                  | Sistemimi i shtratit të përroit të Pustecit<br>Pyllëzimi i pjesëve të zhveshura përgjatë shtratit të përroit;<br>Ndërtimi i gardheve mbrojtëse<br>Ndalimi i hedhjes së çfarëdo lloji të mbetjeve   |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis           | Vetë natyra e ndërhyrjes është në funksion të rritjes së parametrave mjedisorë, si e tillë projekti nuk ka ndikim në mjedis  |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal, bashkia Pustec.   |

|   |   |
|---|---|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Ndërtim rruge me kalldrëm në Liqenas</b>   |
| Tipi i Projektit  | Infrastrukturë rrugore  |
| Vendndodhja e projektit                                     | Fshati Pustec, bashkia Pustec   |
| Buxheti total i Projektit                                   | 27,819,930 Lekë   |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor  |
| Përshkrimi i projektit                                      | <p>Territori i bashkisë ka një rrjet rrugor që nuk i përgjigjet zhvillimeve të ardhshme ekonomike, sidomos në lidhje me zhvillimin e turizmit. Edhe pse viteve të fundit janë bërë investime në rrjetin rrugor, kryesisht rrugët kryesore që përshkojnë territorin, rrugët e tjera që lidhin fshatrat me rrugën kryesore, si dhe rrugët e brendshme të fshatrave ende nuk janë të asfaltuara. Shumica e tyre janë të ngushta dhe nuk lehtësojnë lëvizjen e mjeteve dhe të banorëve. Gjithashtu, rrjeti rrugor lidhës me fshatrat dhe bregun e liqenit pothuajse është inekzistent.</p> <p>Ky projekt synon të përmirësojë rrugën që përshkon fshatin Pustec, që është edhe qendra e bashkisë. Rruga do të shtrohet me kalldrëm duke rritur edhe pamjen estetike të qendrës së fshatit Pustec.</p> <p><b>Përfituesit e drejtëpërdrejtë</b> të këtij projekti janë banorët e fshatit Pustec, ndërsa përfituesit indirekt është e gjithë popullata e bashkisë, turistët dhe vizitorët që viteve të fundit numri i tyre ka njohur rritje.</p> |
| Qëllimi dhe Objektivat                                      | Projekti ka si qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e fshatit Pustec.<br>Objekti i projektit është lehtësimi i qarkullimit të mjeteve dhe  |



|   |  |
|---|--|
|   | banorëve si dhe rritja e atraktivitetit të zonës.  |
| Rezultatet e Pritshme                             | Rritja e atraktivitetit të zonës dhe mundësive për aktivitete pushuese   |
| Rendi Prioritar                                   | Nr.2   |
| Qëndrueshmëria e Projektit                        | Rruga pas investimit do të mirëmbahet nga Bashkia Pustec, si pjesë e kompetencave vendore  |
| Aktivitetet e Projektit                           | Hartimi i projektit teknik; Financimi; Prokurimi dhe zbatimi i punimeve civile; Monitorimi i tyre; dorëzimi dhe mirëmbajtja në vazhdim e kalldrëmit.   |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                    | I gjithë territori i bashkisë është zonë e mbrojtur. Nisur nga ky status çdo ndërhyrje infrastrukturore ka ndikime negative në mjedis që ka të bëjë me pluhura, zhurma, prishja e pejsazhit etj. Duke pasur në konsideratë brishtësinë e zones dhe faktin që është urbane, do të hartohet plani i ndikimit në mjedis dhe si rrjedhim plani i masave zbutëse, për t'u zbatuar me rigorizitet nga të gjithë aktorët e përfshirë. |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Projekti është i gatshëm për zbatim. Nga Bashkia do të merren masa për lirimin e sheshit të ndërtimit i cili është pronë publike   |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar          | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal.   |

|   |   |
|---|---|
| Titulli/Emërtimi i Projektit                                | <b>Asfaltimi i rrugës lidhëse së fshatit Goricë e Vogël</b>   |
| Tipi i Projektit  | Infrastrukturë rrugore  |
| Vendndodhja e projektit                                     | Fshati Goricë e Vogël, bashkia Pustec   |
| Buxheti total i Projektit                                   | 16,000,000Lekë  |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Nuk është parashikuar financim nga buxheti i Bashkisë, për këtë vit buxhetor  |
| Përshkrimi i projektit                                      | <p>Territori i bashkisë ka një rrjet rrugor që nuk i përgjigjet zhvillimeve të ardhshme ekonomike, sidomos në lidhje me zhvillimin e turizmit. Edhe pse viteve të fundit janë bërë investime në rrjetin rrugor, kryesisht rrugëve kryesore që përshkon territorin deri në pikën e kalimit kufitar me Republikën e Maqedonisë, rrugët e tjera që lidhin fshatrat me rrugën kryesore, si dhe rrugët e brendshme të fshatrave ende nuk janë të asfaltuara. Shumica e tyre janë të ngushta, në gjendje teknike të dobët dhe nuk lehtësojnë lëvizjen e mjeteve dhe të banorëve. Gjithashtu, rrjeti rrugor lidhës me fshatrat dhe bregun e liqenit pothuajse është inekzistent. Gjithsesi, prioritet është lidhja e fshatrave me rrugën kryesore për të rritur aksesin në shërbimet bazë dhe forcuar kohezionin social të bashkisë. Ky projekt synon të adresojë lidhjen rrugore të dobët të fshatit Goricë e vogël.</p> <p><b>Përfituesit e drejtëpërdrejtë</b> të këtij projekti janë banorët e fshatit Goricë e vogël, ndërsa përfituesit indirekt janë dhe turistët dhe vizitorët që viteve të fundit kanë njohur rritje. Në fshatin Goricë e</p> |

|   |  |
|---|--|
|   | Vogël ndodhet edhe një shkollë 9-vjeçare që frekuentohet nga fëmijët e fshatrave të afërt. Përfitues direkt janë edhe nxënësit dhe stari mësues i shkollës së fshatit.   |
| Qëllimi dhe Objektivat                            | Projekti ka si qëllim përmirësimin e aksesit në shërbimet bazë dhe rritjen e mundësive të zhvillimit ekonomik dhe bujqësor për banorët e fshatit Goricë e Vogël, nëpërmjet rikonstruksionit të rrugës që lidh këtë fshat me rrugën kryesore.   |
| Rezultatet e Pritshme                             | Rritja e aksesit në shërbimet bazë dhe tregje; lehtësim i lëvizjes së njerëzve dhe produkteve lokale; rritje e nivelit të shërbimeve publike, rritja e aksesit në atraksione turistike.  |
| Rendi Prioritar                                   | Nr.5   |
| Qëndrueshmëria e Projektit                        | Rruga pas investimit do të mirëmbahet nga Bashkia Pustec, si pjesë e kompetencave vendore  |
| Aktivitetet e Projektit                           | Hartimi i projektit teknik; Aplikimi për gjetje fondesh; Financimi; Prokurimi dhe zbatimimi i punimeve civile; Monitorimi i tyre; dorëzimi dhe mirëmbajtja në vazhdim e rrugës.  |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                    | I gjithë territori i bashkisë është zonë e mbrojtur. Nisur nga kjo cdo ndërhyrje infrastrukturore ka ndikime negative në mjedis që ka të bëjë me pluhura, zhurma, prishja e pejsazhit etj. Duke pasur në konsideratë brishtësinë e zonës, do të hartohet plani i ndikimit në mjedis dhe si rrjedhi plani i masave zbutëse, për t'u zbatuar me rigorizitet nga të gjithë aktorët e përfshirë. |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Projekti është i gatshëm për zbatim. Nga Bashkia do të merren masa për lirim e sheshit të ndërtimit i cili është pronë publike   |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar          | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal.   |

|  |   |
|--|---|
| <b>Titulli/Emërtimi i Projektit</b>                                | <b>Trainimi i punonjësve të administratës vendore për një menaxhim të integruar të mbetjeve urbane</b>  |
| <b>Tipi i Projektit</b>  | Menaxhimi i mbetjeve urbane   |
| <b>Vendndodhja e projektit</b>                                     | Bashkia Pustec  |
| <b>Buxheti total i projektit</b>                                   | 500,000 Lekë  |
| <b>Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore</b> | NA  |
| <b>Përshkrimi i projektit</b>                                      | Decentralizimi në kontekstin e menaxhimit mjedisor nisi nga nevoja për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, dhe mbi të gjitha, për një organizim më të mirë të ofrimit dhe menaxhimit të shërbimeve ku përfshihen dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane në nivel vendor. Megjithatë, një kalim i tillë përgjegjësish drejt autoriteteve vendore duhet të merrte parasysh përmasat, natyrën e detyrave dhe kërkesave që lidhen me efektshmërinë dhe ekonominë, si dhe kapacitetet për përballimin e dhënies së shërbimit. Ndaj ndërtimi i kapaciteteve në drejtim të mirëmenaxhimit të mbetjeve përbën një |

|   |  |
|---|--|
|   | <p>prioritet për drejtuesit e Bashkisë për realizimin e potencialeve brenda sistemit të menaxhimit të mbetjeve në mënyrë që sistemi të përformojë në cilësinë e duhur. Rritja e kapacitetit profesional është shumë i rëndësishëm për të plotësuar boshllëqet dhe dobësitë në lidhje me njohuritë ekzistuese dhe dhënien e teknikave të duhura për lehtësimin e dialogut dhe bashkëpunimit midis administratës së shërbimeve dhe publikut.</p> <p><b>Përfituesit:</b> Punonjësit e administratës dhe banorët e Bashkisë Pustec</p>   |
| <b>Qëllimi dhe objektivat</b>                             | <p>Projekti ka si <i>objektiv</i> rritjen e aftësive dhe performancës së stafëve të administratës në drejtim të menaxhimit të mbetjeve urbane</p> <p>Projekti ka si <i>qëllim specifik</i> trajnimin dhe kualifikimin e punonjësve të Bashkisë dhe përshtatjen e tyre me metoda dhe eksperiencë pozitive në vend dhe rajon sipas pozicioneve të punës.</p>   |
| <b>Rezultatet e pritshme</b>                              | <p>Punonjës të aftë për të zbatuar njohuritë mbi menaxhimin e mbetjeve</p> <p>Staf i kualifikuar në hartimin e projekteve në zbatim të planeve dhe strategjive kombëtare</p> <p>Menaxhim më efektiv i mbetjeve urbane në NJQV</p>  |
| <b>Rendi prioritar</b>                                    | Nr.10 në listën e prioriteteve   |
| <b>Qëndrueshmëria e projektit</b>                         | Njohuritë e fitura nga stafi do të aplikohen në praktike dhe transferohen në punonjës të tjerë të administratës  |
| <b>Aktivitetet e projektit</b>                            | <p>Aktivitetet kryesore në këtë projekt janë zhvillimi i kurseve që do të ofrohen në formën e “moduleve”, duke trajtuar tema specifike në mënyrë koherente si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve urbane</li> <li>- Planifikimin praktik të menaxhimit të mbetjeve të ngurta</li> <li>- Aplikimi i praktikave të mira për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin</li> </ul> <p>Këto kurse të shkurtra u japin mundësi individëve që pas përfundimit të tyre, të mund të aplikojnë për një kualifikim zyrtar në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane.</p> |
| <b>Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis</b>                     | NA   |
| <b>Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim.</b> | Gati për t’u zbatuar   |
| <b>Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar</b>           | Projekti është pjesë e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal, bashkia Pustec  |